# GAZETA SHQIPTARE







Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktorë - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com

Viti XXIII - Nr. 7660 E hënë 24 Shtator 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)







Intervista e Ditës

Nga ADELHEID FEILCKE



**Desir: Sulmet ndaj gazetarëve sjellin klimë kërcënimi e vetëcensure**

Zhvillimi i mediave të pavarura në vendet e Ballkanit Perëndimor mbetet si edhe më parë, një temë qendrore e vendeve të Ballkanit Perëndimor", thotë Harlem... Vijon në faqen 20



Opinioni i Ditës

Nga SULEJMAN MATO

**Këshilla praktike për punësim në shtet**

Siç e dimë të gjithë, punësimi në shtetin shqiptar sa vjen e po bëhet më i vështirë, edhe për shkak të vendeve të pakta të punës, ndaj e ndjejmë të nevojshme dhe... Vijon në faqen 21




Ish-ministri i Drejtësisë: Kjo është zgjidhja

## Vetingu në politikë, Bardhi: Si do bëhet kontrolli i figurës. Kush do përjashtohet...

Eksperti ligjor i PD: 'Antimafia', si do të sekuestrohen pasuritë e paligjshme

Nga VALENTINA MADANI

Gazment Bardhi, ish-ministër Drejtësie, aktualisht këshilltar ligjor në PD apelon se procesi i ventingut në politikë nuk mund të presë dot asnjë ditë më shumë. Sipas tij, shkëputja e lidhjeve mes qeverisjes dhe krimit të organizuar dhe largimi i zyrtarëve... Në faqet 2-3

### BASHKIA BEN PERZGJEDHJEN, LISTA E PLOTE E PERFITUESVE NE TIRANE

# NDIHME EKONOMIKE PER 2599 FAMILJE, EMRAT

Mbledhja e Këshillit Bashkiak do jetë më 27 shtator. Vendimet që pritet të miratohen. Mes emrave, edhe viktima të dhunës dhe jetimë




*(Në foto)* Foto ilustruese. Faksimile e propozimit për dhënien e ndihmës ekonomike

Në faqet 8-10

PER ÇFARE AKUZOHEN

**Autorë të 2 vrasjeve në Shkodër, 9 të arrestuarit e fisit Bajri, sot para gjykatës**

Në faqen 11

DETAJET E OPERACIONIT

**Drogë, kallashë e municione, policia greke arreston pesë shqiptarë në 2 qytete**

Në faqen 7

FESTIVALI I TEATROVE

**Fond 8 mln lekë për 14 trupa, Çuli: E vërteta e ndalimit të "Europa Nostra"-s**

Në faqen 19

FLET ASKOLD KUROV

**Sentsov, historia e regjisorit ukrainas që vuan burgun rus për 'terrorizëm'**

Në faqen 18

RAMA, FERMEREVE: BEHUNI PRONARE, AFATET




**KiE, rezolutë për Shqipërinë: Pronat do kompensohen brenda 10 viteve**

Në faqen 5

Mjeku infeksionist: Rreth 100 pacientë, çdo ditë në dyert e Infektivit

## Gentian Stroni: Vaksina kundër gripit, kur bëhet

Ylli Merja: Receta mikse për një zemër të shëndetshme

Nga VOLTIZA DURO

Rreth 100 persona të prekur nga virozat paraqiten çdo ditë pranë Spitalit Infektiv në Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza" në kryeqytet. Me ardhjen e stinës së vjeshtës e ndryshimin e klimës, pacientët paraqesin






probleme të traktit respirator e drejtohen për ndihmë pranë mjekut të lagjes apo në QSUT. Në një intervistë për suplementin "Life Pages" në "Gazeta Shqiptare", mjeku infeksionit Gentian Stroni tregon se deri më tani situata është e qëndrueshme...

Suplement

# VETINGU NË POLITIKË

## INTERVISTA

### Eksperti ligjor i PD: Zgjidhja kundër krimit dhe korrupsionit qeveritar

# Vetingu në politikë, Bardhi: Si do të bëhet kontrolli i figurës

## "Në filtër çdo politikan, SPAK dhe BKH s'bëjnë veting"

Valentina Madani

*Gazment Bardhi, ish-ministër Drejtësie, aktualisht këshilltar ligjor në PD apelon se procesi i ventingut në politikë nuk mund të presë dot asnjë ditë më shumë. Sipas tij, shkëputja e lidhjeve mes qeverisjes dhe krimit të organizuar dhe largimi i zyrtarëve të korruptuar është emergjencë kombëtare. Z.Bardhi gjykon se zyrtari i shkarkuar nga vetingu shkon përpara drejtësisë pa "kostumin" e rëndë të zyrtarit publik dhe nëse ka kryer krime, shkon në burg. Z.Bardhi, një njohës i mirë i ligjit thotë për "Gazeta Shqiptare" se procesi do të jetë i thjeshtë dhe i ngjashëm me atë që ndiqet edhe në procesin e dekriminalizimit. Strukturat përgjegjëse për realizimin e këtij procesi do të jenë të pavarura nga politika dhe më shumë se një organ, për të kontrolluar dhe balancuar njëri-tjetrin. Zyrtari i lartë i PD-së dënon tentativat e kryeministrit Rama për të manipuluar opinionin publik, me qëllimin e deformimit të qëllimeve të vërteta të procesit të vetingut të politikanëve. Z.Bardhi bën të ditur se PD është në kontakt me ndërkombëtarët dhe ka marrë inkurajimin e tyre teksa kujton se "edhe në rastin e Ligjit për Dekriminalizimin, opozitës iu deshën më shumë se 6 muaj që të merrte mbështetje institucionale të partnerëve për procesin e dekriminalizimit". Eksperti ligjor i PD flet edhe për ngërçin në sistemin e drejtësisë, ndryshimet që PD po i bën ligjit antimafia si dhe 'paligjmërinë' e vendimeve të kryeprokurores Arta Marku.*



Gazment Bardhi, ish-ministër i Drejtësisë

**VETINGU**

"SPAK dhe BKH nuk bëjnë veting, sepse vetingu është procesi administrativ i pastrimit të zyrave të shtetit nga politikanë të lidhur me krimin dhe që nuk justifikojnë pasurinë e tyre", u shpreh z.Bardhi.

**Z. Bardhi pse pikërisht tani PD-ja ka ndërmarrë një nismë kushtetuese për vetingun në politikë dhe si është menduar realizimi i këtij propozimi? Çfarë synohet konkretisht?**

Partia Demokratike ka propozuar përfshirjen e zyrtarëve të lartë publikë në procesin e vetingut, që në kohën e diskutimit mbi Reformën në Drejtësi. Të njëjtën kërkesë e kemi përsëritur zyrtarisht edhe në momentin ku u miratua procesi i vetingut për punonjësit e Policisë së Shtetit dhe Gardës së Republikës. Tashmë, ky proces nuk mund të presë dot asnjë ditë më shumë. Shkëputja e lidhjeve midis qeverisjes dhe krimit të organizuar dhe largimin i zyrtarëve të korruptuar e të lidhur me krimin është emergjencë kombëtare. Procesi është menduar të ndjek të njëjtat standarde, siç aplikohet edhe për gjyqtarët dhe prokurorët. Mendoj se politikanët nuk kanë asnjë arsye që të trajtohen ndryshe. Procesi do të jetë i thjeshtë dhe i ngjashëm më atë që ndiqet edhe në procesin e dekriminalizimit. Strukturat përgjegjëse për realizimin e këtij procesi, do të jenë të pavarura nga politika dhe më shumë se një organ, për të kontrolluar dhe balancuar njëri-tjetrin. Synimi është pastrimi i politikës nga individët e lidhur me krimin e organizuar apo individët që nuk justifikojnë ligjërisht pasurinë e tyre. Vetëm në këtë mënyrë, arrijmë të kemi politikanë e zyrtarë, që nuk punojnë për krimin e organizuar dhe veten e tyre, por për problemet e njerëzve të zakonshëm të këtij vendi.

**Ka të drejtë kryeministri Rama kur thotë se nuk mund të hiqen politikanët nga jeta parlamentare vetëm se iu gjet një fotografi me një person të inkriminuar, ndërsa e ka quajtur këtë si një tentativë të opozitës për të bllokuar drejtësinë?**

Në fakt, nuk bëhet fjalë për këtë. Nuk bëhet fjalë për një fotografi. Bëhet fjalë për kontakte të qëllimshme dhe të vazhdueshëm, që nuk përputhen me detyrën shtetërore, midis një politikani dhe eksponentëve të krimit të organizuar. Bëhet fjalë për individë që punojnë çdo ditë për t'i dhënë tendera dhe koncesione eksponentëve të krimit të organizuar. Është e qartë që deformimi i qëllimeve të vërteta të procesit të vetingut të politikanëve nga kryeministri Edi Rama është një tentativë për të manipuluar opinionit publik, për shkak se nuk e do vetingun. Mos u habisni. Kemi dëgjuar këto ditë justifikime nga më absurdet për mungesën e vullnetit të Edi Ramës për vetingun në politikë. Është qesharake të thuash se largimin nga qeverisja e individëve të lidhur me krimin e organizuar apo që nuk justifikojnë pasurinë e tyre, pengon drejtësinë. Si e pengon drejtësinë shkëputja e lidhjeve midis qeverisjes dhe krimit? Si e pengon drejtësinë largimi nga funksioni publik i zyrtarëve të korruptuar? Kurrsesi nuk e pengon, veç e ndihmon. Zyrtari i shkarkuar nga vetingu shkon përpara drejtësisë pa "kostumin" e rëndë të zyrtarit publik dhe nëse ka kryer krime, shkon në burg.

**HETIMI**

"Në hetimin penal është detyrë e SPAK dhe BKH që të provojë që politikani është i lidhur me krimin apo që politikani nuk e ka të ligjshme pasurinë. Pra, janë dy procese të ndryshme që nuk pengojnë, por ndihmojnë njëra-tjetrën", tha eksperti ligjor i PD.

**Ku ndryshon vetingu i politikanëve nga vetingu në drejtësi? Si do të bëhet kontrolli i figurës?**

Standardet e vetingut të lidhjes së politikanit me krimin do të jenë të njëjta si dhe për rastin e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Edhe procedura se si identifikohen faktet dhe arrihet në konkluzion do të jetë e njëjtë. Procesi i kontrollit të figurës do të jetë i ngjashëm me modelin e ligjit të dekriminalizimit. Detyra do u ngarkohet disa institucioneve, të cilat në përmbushje të roleve të ngarkuara me ligjin për zbatimin e vetingut të politikanëve, do të plotësojnë dhe kontrollojnë njëra-tjetrën.

**PD-ja përmes deputetit Salianji ka përmendur një 'listë të zezë' me 100 emra, të cilët preken nga vetingu i propozuar nga PD. Por si janë identifikuar këta persona, kush janë ata dhe a ka bërë PD një "hetim" paraprak për pushtetarët dhe politikanët e lidhur me krimin para se të ndërmerrte nismën për vetingun e politikanëve?**

Partia Demokratike, por edhe media, çdo ditë zbulojnë fakte sesi politikanët dhe qeveritarët janë në lidhje të ngushtë me eksponentë të krimit të organizuar. Rastet 'Xhafaj', 'Balla', 'Bushati', 'Çyrbja' etj., janë vetëm disa nga shembujt tronditës, sesi pushteti është vënë në shërbim të krimit të organizuar. Partia Demokratike nuk ka bërë dhe nuk do bëjë "hetim", sepse nuk është detyra jonë. Ne kemi propozuar një mekanizëm ligjor sesi kjo duhet të bëhet dhe është detyrë e institucioneve të pavarura nga politika, të realizojnë procesin e verifikimit dhe të bëjnë vetingun e politikanëve. Nuk ka listë të zezë apo të bardhë, sepse ndarjen në "të zezë" dhe "të bardhë", duhet ta bëjë procesi ligjor i vetingut të politikanëve. Partia Demokratike është gati për këtë ndarje. Qeveria deri më tani ka refuzuar. Por pavarësisht kësaj, vetingu do të bëhet, sepse Shqipëria nuk mund të jetë peng i politikanëve të lidhur me krimin dhe të korruptuar.

**Konkretësia e vë qeverinë me shpatulla pas murit, e turpëron para qytetarëve, ndaj opozita vazhdon të identifikojë me të drejtë se lidhjet e politikës me krimin janë rreziku më i madh për demokracinë?**

Detyra e opozitës është pikërisht kjo. Të evidentojë lidhjet e qeverisë me krimin e organizuar dhe milionat euro që ajo u jep eksponentëve të botës së krimit, nëpërmjet tenderave e koncesioneve të paligjshme. Kjo lidhje e ngushtë mes qeverisë dhe krimit të organizuar po rrezikon jo vetëm demokracinë, por edhe stabilitetin në vend. Kjo situatë është pengesë kryesore pse sot nuk kemi rritje rrogash apo pensionesh, ndihmë më të madhe ekonomike për të pamundurit, shërbim më të mirë shëndetësor apo arsimor dhe sigurisht pse kemi ngecur në procesin e integrimit të Shqipërisë në 5 vjet.

**Të gjithë duan largimin e pushtetarëve të lidhur me krimin, por pse kjo nismë nuk ka marrë ende mbështetje institucionale të SHBA-ve dhe BE-së? Kam parasysh këtu pasi nismat e mëdha ligjore antikrim dhe antikorrupsion në Shqipëri së fundmi janë realizuar në bashkëpunim të ngushtë me SHBA dhe BE. Kjo ndodhi me ligjin e dekriminalizimit apo vetë Reformën në Drejtësi, që ka bashkautorësi amerikane dhe europiane në hartim dhe në zbatim…**

Unë nuk do thosha se nisma nuk ka marrë mbështetje institucionale nga partnerët tanë ndërkombëtarë. Në jemi në kontakt të vazhdueshëm me ta dhe kemi marrë inkurajimin për ta çuar përpara. Më lejoni t'ju kujtoj se edhe në rastin e Ligjit për Dekriminalizimin, opozitës iu deshën më shumë se 6 muaj që të merrte mbështetje institucionale të partnerëve për procesin e dekriminalizimit. Fillimisht për partnerët ishte e pabesueshme ajo që thoshte opozita, sepse nuk mund të imagjinonin që në drejtimin e shtetit kishte zyrtarë të dënuar për trafik droge, trafik qeniesh njerëzore, përdhunim apo vrasje. Por me shumë durim dhe vendosmëri, PD arriti të siguronte mbështetjen e tyre dhe falë asaj mbështetjeje, qeveria u detyrua të pranonte ligjin e dekriminalizimit, që largoi nga funksionet drejtuese të shtetit plotë 333 zyrtarë publik me rekorde kriminale.

**Zv.Ndihmës-sekretarja e Shtetit, Elisabeth Millard zgjedh reformën në drejtësi si rrugën e vetme për të pastruar politikën nga krimi dhe korrupsioni. E pyetur gjatë një interviste për "News 24" për vetingun në politikë, Millard këmbënguli se "çelësi është SPAK dhe BKH". Cili është komenti juaj lidhur me deklaratën e saj?**

E kam dëgjuar intervistën e znj. Millard dhe jam dakord që SPAK dhe BKH janë mekanizmi i vetëm që do të hetojë dhe ndëshkojë zyrtarët që kanë kryer krime. Propozimi ynë për veting nuk e prek apo


Gjatë një seance parlamentare

REDAKSIA: **Redaktor i Suplementeve dhe Sociales:** Rezarta Delisula, **Redaktor i Rretheve:** Trëndafile VISHA, **Redaktor i Kulturës:** Fatmira Nikolli, ***Art Designer:*** Nevila SAMARXHI.
ADMINISTRATA: **Përgjegjëse e Financës:** Alma Smokthina 0682074397, **Shpërndarja:** Elvis Llaka Cel 0682074416, ***Marketingu*:** Cel:0682074415-***email:marketing@gazetashqiptare.com*, ADRESA**: Ish-Drejtoria e Uzinës së Autotraktorëve, Tiranë - Tel:(04) 2359-104 Tel&Fax:(04) 2359-116 ***Marketingu*:** Tel:(04) 2359-104/359-123. Tiranë, **Internet**: www.balkanweb.com, **Email**: gazetashqiptare@hotmail.com; redaksia@gazetashqiptare.com, **SHTYPUR në "Klasik"Shpk**



"Inkurajim nga partnerët, për dekriminalizimin na u deshën 6 muaj që t'i bindnim"

# PD, Bardhi: Ngërçi në drejtësi, Rama po mbyll aferat qeveritare

## "Antimafia, si do sekuestron pasuritë e paligjshme"

pengon këtë. SPAK dhe BKH nuk bëjnë veting, sepse vetingu është procesi administrativ i pastrimit të zyrave të shtetit nga politikanë të lidhur me krimin dhe që nuk justifikojnë pasurinë e tyre. Në veting kalojnë në filtër të gjithë politikanët, pa përjashtim, me qëllim që të zbulohen fakte dhe prova, që i largojnë ato nga zyrat e shtetit apo i pengojnë të hyjnë në zyrat e shtetit. Në veting detyrimin për të provuar ligjshmërinë e pasurisë dhe faktin që nuk janë të lidhur me krimin, e ka vetë zyrtari dhe jo shteti. Ndërsa hetimi penal ka tjetër procedurë. Jo të gjithë politikanët kalojnë në filtrin e hetimit. SPAK dhe BKH do hetojnë vetëm politikanët për të cilët ose ka kallëzim penal, ose janë zbuluar paraprakisht fakte apo prova që tregojnë se mund të kenë kryer një vepër penale. Në hetimin penal është detyrë e SPAK dhe BKH që të provojë që politikani është i lidhur me krimin apo që politikani nuk e ka të ligjshme pasurinë. Pra, janë dy procese të ndryshme, që nuk pengojnë, por ndihmojnë njëra-tjetrën.

**Dekriminalizimi i politikës është kyç për Shqipërinë, por pse nuk vihen në zbatim ligjet e miratuara?**

Dekriminalizimi ishte një proces jetik për Shqipërinë dhe që dha rezultatet e veta. Menjëherë pas miratimit të ligjit të dekriminalizimit, Edi Rama gjeti një formë të re të vijimit të bashkëpunimit me krimin. Sot në parlament, qeveri apo pushtet vendor nuk kemi vërtetë individë të dënuar, por kemi shërbëtorët e tyre dhe njerëz që janë vendosur nga krimi i organizuar që kontrollin sot shtetin. Është krimi i organizuar, që nëpërmjet zyrtarëve që ka vendosur vetë dhe që janë të lidhur me të, vendosin për mënyrën sesi shpërndahet Buxheti i Shtetit, se kush i merr tenderat, se kush do jetë koncesioni i radhës, etj. Ne duhet t'i përgjigjemi kësaj situate me ligjin përkatës, që nis me ndryshimet kushtetuese që i hapin rrugë procesit të vetingut të politikës.

**Kryetari i PD-së, Lulzim Basha ka paralajmëruar prezantimin e projektligjit antimafia. Ku konsiston dhe kë prek ky projektligj?**

Ashtu si ka paralajmëruar kryetari i PD-së, z. Basha, tenderat dhe koncesionet korruptive, do duhet të anulohen dhe të ndalen, sepse janë një shpërdorim i parave dhe pasurisë së shqiptarëve, për qëllime klienteliste dhe korruptive. Ndryshimet në Ligjin Antimafia do të konsistojnë në miratimin e rregullave që kalojnë në verifikim të gjitha kontratat e koncesionit, prokurimit publik, partneritetit publik-privat, tjetërsimit t? pasurive publike dhe aktet e lejeve, licencave ose autorizimeve për shfrytëzimin e pasurive publike. Për kontratat publike korruptive dhe klienteliste, ligji do parashikojë jo vetëm anulimin e tyre, por edhe konfiskimin e pasurisë së kompanive private përfituese dhe pronarëve të këtyre kompanive, si dhe pasurisë së zyrtarëve publik që kanë abuzuar me detyrën.

**Pse ka ngecur reforma në drejtësi?**

Jemi në vitin e tretë nga miratimi i Reformës në Drejtësi dhe ende sot nuk kemi në funksionim asnjë nga institucionet e reja të sistemit të drejtësisë dhe se sistemi është në një ngërç, që e ka lënë Shqipërinë pa Gjykatë Kushtetuese dhe pa Gjykatën e Lartë dhe me një Prokurori të kontrolluar nga qeveria dhe krimi i organizuar i lidhur me pushtetin. Përgjegjësia direkte për këtë është e qeverisë, e cila ka futur në ngërç sistemin e drejtësisë dhe punon çdo ditë sesi ta kapë atë politikisht, për ta vënë drejtësinë në funksion të mbylljes së aferave të veta korruptive dhe për të shpëtuar nga burgu eksponentët e krimit të organizuar të lidhur me të.

**Çdo të thotë 'një vend pa gjykata' siç është sot Shqipëria? Si mund të zgjidhet ngërçi në sistemin e drejtësisë?**

Një "vend pa gjykata" do të thotë një vend ku të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, nuk ka kush i mbron do të thotë një vend që nuk frenon dot me mjete ligjore abuzimet e qeverisë, do të thotë një vend që nuk lufton dot korrupsionin dhe krimin e organizuar. Sepse është detyrë e sistemit të drejtësisë të mbrojë qytetarët nga abuzimet e qeverisë dhe është detyrë e sistemit të drejtësisë të dënojë korrupsionin dhe krimin e organizuar. Zgjidhja është mbi tavolinën e Edi Ramës. Heqja dorë nga bllokimi i Reformës në Drejtësi dhe tentativa për kapjen politike të sistemit të drejtësisë. Për këtë opozita ka paraqitur që në muajin korrik një paketë me 7 propozime për daljen nga ngërçi ku e ka futur qeveria Reformën në Drejtësi. 7 propozimet e opozitës për zgjidhjen e kolapsit të krijuar nga ndërhyrjet politike për kapjen e drejtësisë janë: 1.Respektimi i Kushtetutës së miratuar me konsensus në korriku 2016, që do të thotë zhbërje e ligjeve në kundërshtim me Kushtetutën. 2.Zgjidhja e situatës së paligjshmërisë në organin e Prokurorisë, duke i dhënë fund kapjes politike të Prokurorit të Përgjithshëm. 3.Zgjidhja e situatës së paligjshmërisë në procedurën e përzgjedhjes së anëtarëve të jashtëm të KLGJ-së e KLP-së. 4.Zgjidhja urgjente e ngërçit të krijuar në Gjykatën Kushtetuese. 5.Zgjidhja urgjente e ngërçit për ngritjen sa më shpejt të KLGJ dhe KLP sipas Kushtetutës, që të zhbllokohet edhe krijimi i SPAK dhe BKH. 6.Ecuria kushtetuese dhe ligjore e procesit të vetingut. Ndërprerja e menjëhershme e ndërhyrjes politike në proces nga ana e maxhorancës, që ka sjellë deri tani një proces të deformuar. 7.Ngritja e një komisioni koordinimi i balancuar dhe i paanshëm për të mbikëqyrur konstituimin e organeve të reja të drejtësisë. Sipas parashikimeve kushtetuese duhet të ishte ngritur më parë.

**Pse kaq shqetësuese për opozitën transferimi i prokurorëve nga zj.Marku?**

**Pse është i jashtëligjshëm hetimi i tyre?**

Arta Marku është emëruar në detyrë në mënyrë të paligjshme nga Edi Rama, pikërisht për të bërë këtë që po bën sot. Nëpërmjet transferimeve të paligjshme dhe procedimeve disiplinore pa shkak të ligjshëm ndaj prokurorëve, Arta Marku po tenton të dështojë hetimet e rëndësishme që ata kanë në dorë, përfshirë çështjen e Saimir Tahirit. Ligji nuk lejon Prokurorin e Përgjithshëm të Përkohshëm të transferoi pa pëlqim prokurorët e Krimeve të Rënda, apo të bëjë lëvizjen e tyre nga çështje konkrete. Kjo është ndërhyrje e paligjshme në punën e pavarur të prokurorëve. Ndërkohë, procedimi disiplinor pa shkak ndaj tyre është formë presioni ndaj prokurorëve dhe pa asnjë dyshim që është kriminal e i paligjshëm.

**Opozita përveç kallëzimit penal ka kërkuar edhe largimin e Arta Markut? Nga kryeprokurore e përkohshme, Marku po shkon drejt kryeprokurores së përhershme? Si mund ta ndalojë ligjërisht opozita?**

Opozita ka depozituar në Prokurorinë e Tiranës një kallëzim penal për shpërdorim detyre ndaj Arta Markut, e cila me veprime të kundërligjshme, për pengon hetimin e disa zyrtarëve të lidhur me qeverinë apo bandave që i shërbejnë qeverisë. Që hetimi i të jetë real, meqenëse bëhet nga vartësit e Arta Markut, atëherë ligjërisht ajo duhet të pezullohet nga detyra derisa të përfundojnë hetimet. Qëndrimi i saj në detyrë gjatë periudhës së hetimit është prova më e qartë që ajo ka shpërdoruar detyrën dhe se kërkon mbrojtje nga pozicioni i saj si kryeprokurore. Nga e mërkura, Arta Marku nuk është më kryeprokurore e Shqipërisë, por një shërbëtore e zellshme ndaj krimit dhe korrupsionit qeveritar.

**Lidhur me miratimin e ligjit për Teatrin e ri Kombëtar, sipas jush ku u shkel ligji? Kushtetuta thotë se presidenti nuk mund të kthejë dy herë të njëjtin ligj, por sipas jush cila është "hileja" e qeverisë për t'i hequr mundësinë z.Meta që ta rrëzojë sërish ligjin e ri për Teatrin Kombëtar?**

Pas miratimit të Dekretit të Presidentit, pa asnjë rezervë nga Kuvendi, ligjërisht ligji korruptiv "Rama-Fusha" ka rënë dhe nuk ekziston më. Presidenti i është dërguar një ligj, që në fakt nuk është ligj në kuptimin kushtetues, sepse është rrjedhojë e një procesi parlamentar të paligjshëm dhe si i tillë nuk mund të sjell pasoja. Edi Rama e dinë këtë, prandaj ka nxjerrë jashtë funksioni Gjykatën Kushtetuese, që të jetë i pashqetësuar në aferat e veta korruptive. Presidenti i Republikës kam bindjen se do t'i jap përgjigjen e duhur kushtetuese këtij puçi kushtetues të realizuar të enjten e kaluar në Parlament.

### MBËSHTETJA

"Ne jemi në kontakt të vazhdueshëm me partnerët tanë ndërkombëtarë dhe kemi marrë inkurajimin për ta çuar përpara. Më lejoni t'ju kujtoj se edhe në rastin e Ligjit për Dekriminalizimin, opozitës iu deshën më shumë se 6 muaj që të merrte mbështetje institucionale të partnerëve për procesin e dekriminalizimit", u shpreh Bardhi.




### DOSJET

PD e konsideron si sulm nga Arta Marku, atë të procedimit disiplinor të prokurorëve të Krimeve të Rënda. Sipas këshilltarit ligjor Gazment Bardhi, ky është skenar i Ramës për të prishur dosjet nën hetim të bashkëpunëtorëve të afërt të tij. Sipas Bardhit, dokumenti provon se shpërbërja dhe ndëshkimi i grupit hetimor për Saimir Tahirin erdhi pas urdhrit për sekuestrimin e 31 pasurive të Habilajve.

## Basha prezanton sot ndryshimet në Ligjin Antimafia, ja 3 shtyllat

Kreu i PD, Lulzim Basha do të prezantojë sot alternativën e PD për ndryshimet në Ligjin Antimafia, që sipas PD kanë për qëllim sekuestrimin e pasurive publike të fituara me kontrata në kundërshtim me ligjin. Mësohet se aktiviteti do të zhvillohet në orën 11:00 tek hotel "Tirana", ndërsa prezantimi i ndryshimeve në Ligjin Antimafia konsiston në tri shtylla kryesore: 1. Abuzimi me koncesionet, lejet, tenderat. 2. Kostot e abuzimeve nga koncesionet/PPP. 3. Alternativa e zgjidhjes. Pas prezantimit të kësaj alternative, kreu i PD Lulzim Basha do mbajë edhe një fjalim.



# QEVERISJA
## AKUZAT

Akuzat ndaj ministrisë, Ahmetaj: S'ka koncesion, vazhdojmë reformat

# Koncesionet, përplasja mes qeverisë e opozitës

## Tabaku: Sistemi i tatimeve, aferë korruptive



Gjatë një mbledhjeje të qeverisë



Jorida Tabaku



Arben Ahmetaj

Valentina Madani

Qeveria dhe opozita hodhën dje akuza dhe kundërakuza ndaj njëra-tjetrës për koncesionet. Në qendër të debatit janë ministri i Financave dhe Ekonomisë, Arben Ahmetaj dhe deputetja e PD-së, Jorida Tabaku të cilët edhe dje reaguan lidhur me sistemin e ri të monitorimit të transaksioneve të biznesit. Tabaku deklaroi se koncesioni i sistemit të tatimeve është aferë korruptive, por ministri Ahmetaj i është përgjigjur në "Facebook" duke thënë se nuk ka koncesion për këtë sistem të aplikuar. "Dje një duet i dobët përçartjeje publike, sot një solo për të ardhur keq. Është e kotë t'iu përgjigjesh për çdo budallallëk! Nuk ka koncesion zonjë! Por si duket, ju dhe partia juaj ia keni koncesionuar mendjen paditurisë. Ne mbetemi të vendosur të çojmë përpara reformat, të vazhdojmë uljen e lehtësimin e mëtejshëm të ngarkesës fiskale për biznesin e qytetarët dhe të fokusojmë të gjithë vëmendjen tek njerëzit e tek puna në shërbim të tyre", - shprehet z.Ahmetaj. Por nënkryetarja e Komisionit të Ekonomisë pranë PD-së, Jorida Tabaku, i është përgjigjur ministrit të Financave dhe të Ekonomisë, Arben Ahmetaj në lidhje me koncesionin e sistemit të tatimeve. Tabaku shkruan në "Facebook" se ky koncesion nuk është gjë tjetër, por një skemë korruptive e ministrit dhe qeverisë. Duke denoncuar me forcë këtë veprim të ministrit të Financave dhe të Ekonomisë, Tabaku shton se në vijim do të ketë fakte të tjera për këtë koncesion. "Koncesioni i sistemit të tatimeve, aferë korruptive! Katër vjet më parë ministri Ahmetaj në kundërshti me çdo logjikë dhe shifër i gënjente shqiptarët se koncesioni i TVSH-së kishte 0 kosto shtesë për biznesin. Pastaj u tha shqiptarëve se koncesionet në formën e PPP nuk janë lekët e shqiptarëve, por të buxhetit të shtetit. Çfarë e shtynte zotin Ahmetaj të bëhej gazi i botës? Formula magjike e kryeministrit Rama 'Nuk ka supë qyl në karrigen e ministrit'! Kështu, sharlatanët janë turrur kush e kush gënjen më shumë dhe më paftyrësisht për të ruajtur karrigen dhe për të bërë dallaveren e radhës. Si fjala vjen inceneratorët. Edhe meqenëse nuk ka karrige falas, afërmendsh që nuk do të ketë një sistem që s'do jetë barrë për konsumatorët dhe bizneset. Përrallat e propagandës qeveritare nuk i duhet besuar. Skeptikët mjaftojnë të shohin faturën e energjisë, rrogën në xhep (nëse u ka mbetur), kostot e larta dhe mbi të gjitha taksat se ku shkojnë. Koncesioni tatimeve është një tjetër thelë e buxhetit që korruptët e qeverisë duan ta gllabërojnë! Në ditët në vijim më shumë fakte për këtë koncesion dhe për të tjerat. Sa më shumë thërrasin gënjeshtër, aq më shumë do t'u tregojmë vjedhjet!", shprehet zj.Tabaku.

### Denoncimi i koncesoioneve

PD denoncoi dje koncesionin në fushën e kontrollit të pompave të karburantit. Sipas deputetes Izmira Ulqinaku, koncesionari do të fitojë 60 milionë euro, ndërsa secilit biznes, pajisjet e reja do t'i kushtojnë minimalisht 600 euro. "Kontrolli i matjes së pompave të naftës, për shkak të kriterëve të vendosura që tenderi të fitohet vetëm nga kompania e Gentian Sulës, vendos monopolin në treg, duke shkatërruar garën dhe duke thelluar përqendrimin e ekonomisë në pak duar", tha deputetja e PD-së.

## Opozita prezanton sot platformën ekonomike, ndryshohen disa ligje

Opozita e ka gati atë që e quan platformë për rikthimin në shina të sigurisë, ekonomisë dhe drejtësisë. Partitë opozitare parlamentare do të prezantojnë sot paketën antikorrupsion, e cila në thelbin e saj ka ndryshimin e një serie ligjesh që sipas deputetes Jorida Tabaku u japin fund koncesioneve dhe kontratave kurruptive dhe nxjerrin jashtë tregut kompani fantazmë. "Ideja kryesore që përshkon të gjithë pjesën ekonomike të paketës lidhet me luftën ndaj korrupsionit, jo vetëm në parim, por duke propozuar masa konkrete ligjore, duke filluar që nga PPP, ligji për koncesionet, ligji për qiratë e pronave publike, që po i shkojnë një grupi të caktuar njerëzish. Çfarë do të bëhet për të ulur borxhin publik dhe çfarë ndikimi ka në kontratat e PPP në borxhin publik", theksoi deputetja e PD-së. Tabaku, sqaron për "Ora News" se paketa e opozitës ka propozime konkrete, kryesisht në përpjekje për të pamundësuar futjen në sistem për të pastruar paratë e krimit dhe korrupsionit. "Mund të përmend 2-3 masa që lidhen me PPP. PD ka denoncuar aferën e incineratorëve, aferën e teatrit, afera të tjera që lidhen me koncesionet dhe në mënyrë konkrete ne kemi propozuar që asnjë kompani që ka burime 'offshore' nuk mund të marrë pjesë në tendera dhe koncesione publike. Asnjë kompani që nuk është specifike në fushën e vet dhe sapo është krijuar nuk mund të marrë pjesë në tendera publikë dhe koncesione. Kemi propozuar gjurmimin e parave që vijnë nga krimi i organizuar. Kemi propozuar identifikimin e burimeve për çdo investim publik ose privat, sepse ka pasur një shqetësim për rritjen e ndërtimit me fonde të pajustifikaura nga sektori bankar", deklaroi nënkryetarja e Komisionit të Ekonomisë. Paketa ekonomike e opozitës dhe masat antikorrupsion do të diskutohet gjerësisht me qytetarët.



### Vasili: Do të zbatojmë 100% Kodin Zgjedhor

## KQZ, beteja e re qeveri-opozitë, 4 anëtarëve u mbaron mandati

Fushëbetejës së politikës pritet t'i shtohet një tjetër front, ai për kontrollin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Sipas "Top Channel", sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit ka njoftuar tashmë Komisionin e Ligjeve, se 4 nga 7 anëtarët e KQZ-së janë në përfundim të mandatit dhe se duhen nisur procedurat për zëvendësimin e tyre. Bëhet fjalë për Bledar Skënderin, të propozuar nga PS, Hysen Osmanajn dhe Vera Shtjefnin, të propozuar nga Partia Demokratike, si dhe Gëzim Veleshnjën, të propozuar nga LSI. Tre të parët do të zëvendësohen nga të njëjtat forca politike që i kishin propozuar më parë, ndërsa te Veleshnja, çështja nis të komplikohet. Ai kishte marrë mandatin si propozim i LSI-së kur kjo ishte pjesë e mazhorancës. Tani që LSI është në opozitë, PS pretendon se posti që do të lërë bosh Gëzim Veleshnja u takon socialistëve, si e vetmja forcë politike e shumicës parlamentare, gjë që do të linte LSI-në të papërfaqësuar në KQZ. Brenda radhëve të opozitës, LSI ka të drejtë të kërkojë anëtarin e saj në KQZ si partia e dytë me 18 deputetë e pakicës parlamentare. PD do të duhet të zgjedhë nëse një prej dy propozimeve të saj do t'ia lërë LSI-së. Varianti tjetër është që të kërkohet shkarkimi i Denar Bibës, i cili de fakto i përket PS-së, por de jure rezulton si propozim i Partisë Republikane. Kjo situatë është fryt i marrëveshjes 'Rama-Basha' të 17-18 majit 2017, me të cilën kryeministri i dha opozitës shumicën dhe drejtimin e KQZ-së. Për të realizuar këtë, Denar Biba kaloi nga kryetar në anëtar dhe nga socialist në republikan. Ndërsa Klement Zguri shkëmbeu vendin me të, duke kaluar nga anëtar në kryetar dhe nga republikan në socialist, të paktën ligjërisht. Nëse opozita do të kërkojë shkarkimin e Denar Bibës për t'i dhënë vendin e tij LSI-së, kjo nuk përjashton që edhe mazhoranca të kërkojë shkarkimin e Klement Zgurit, ndonëse një gjë të tillë socialistët e tentuan një vit më parë, por pa sukses, pasi kryetari i KQZ-së gëzoi mbrojtjen e ndërkombëtarëve, që i vlerësuan punën në menaxhimin e procesit zgjedhor 2017. Cilido qoftë skenari, me plotësimin e mandateve të reja, e sigurt duket se socialistët do të rifitojnë shumicën prej 4 anëtarësh në KQZ, de fakto apo de jure.

Ne kuader te zbatimit te projektit te dixhitalizimit te sherbimit noterial kombetar per venien ne funksionim te databazes shteterore NISA, Dhoma Kombetare e Noterise (DH.K.N.) fton Operatoret Ekonomike te huaj ose vendas per te marre pjese ne kete procedure.
Dokumentat e projektit mund te terhiqen perkundrejt pageses prej **10.000 leke,** prane Dh.K.N. ne adresen Rruga Vaso Pasha, Tirane, Shqiperi.
Propozimet do te pranohen brenda dates **7 tetor 2018 ora 10:00 AM**

albius

**Zyra e Përmbarimit Albius**, me përmbarues gjyqësor privat Zef Macaj, në bazë të vendimit nr. 1857, datë 19 Shtator 2018, shpall shitjen në ankand të pasurisë pasurisë "Ndërtesë", me sipërfaqe 115 m2, me numër pasurie 6/596/ND, volumi 37, faqe 111, zona kadastrale nr. 8120, me adresë : Rr. " Niko Avrami", Tiranë, në vlerën **43, 361.6 (dyzet e tre mijë e treqind e gjashtëdhjetë e një, pikë gjashtë) Euro**.

Ankandi zhvillohet në ambjentet e Zyrës të Përmbarimit Albius, në adresën : Bulevardi "Gjergj Fishta", Ndërtesa nr. 6, Hyrja nr. 3, Apartamenti nr. 8, Njësia Administrative nr. 10, 1001, Tiranë, ditën **e Enjte**, me datë **19 Shtator 2018**, ora **16.15**.



Rezoluta e KiE për pronat, Gjonaj: Vendimi, përgjigje për retorikën e opozitës

# KiE, rezolutë për Shqipërinë: Pronat do kompensohen brenda 10 viteve

## "Procesi i kompensimit, i garantuar"

Komiteti i Ministrave të Evropës miratoi rezolutën për mbylljen e procesit të mbikëqyrjes së masave të përgjithshme për grupin e çështjeve që lidhen me kompensimin e pronave, duke përfshirë këtu edhe planin e masave të vendimit. Në rezolutë theksohet se Shqipëria ka arritur rezultatet konkrete të angazhimit politik të nivelit më të lartë për të siguruar funksionimin e këtij mekanizmi. Komiteti i Ministrave të Evropës duke vlerësuar punën e qeverisë shqiptare për trajnimin e pronave, thekson faktin se plani i kompensimit të pronave do të mbyllet brenda një periudhe 10-vjeçare, një zhvillim ky, i cili garanton çdo pronar, pasi prona e tij do të kompensohet sipas një plani të studiuar. Në njoftimin e Ministrisë së Drejtësisë thuhet: "Nëpërmjet kësaj zgjidhjeje, Komiteti i Ministrave ka vendosur se Shqipëria i ka dhënë fund mungesës së gjatë të një mekanizmi efektiv si dhe është vlerësuar mbështetja politike, financiare dhe teknike që është dhënë nga qeveria shqiptare që nga viti 2014 e në vazhdim". Në këtë rezolutë, sqaron Ministria e Drejtësisë dukshëm janë vlerësuar rezultatet sinjifikative si në trajtimin e kërkesave të vlerësuara me vendim nga Agjencia e Trajtimit të Pronave, numrit të vendimeve të zbatuara të kësaj agjencie si dhe vendosjen në dispozicion të burimeve financiare tejet të konsiderueshme nga qeveria Shqiptare, për të mbuluar të gjitha pagesat e pronarëve për kompensim. "Vendimi i marrë nga Komiteti i Ministrave tregon se Shqipëria i ka vendosur në zbatim të gjitha masat e vendosura nga Gjykata Evropiane dhe Komiteti i Ministrave duke vendosur të mos ushtrojë më mbikëqyrjen e kësaj çështje. Komiteti i Ministrave vlerëson angazhimin konkret të qeverisë në përmbushjen e detyrimeve të vendimeve të Gjykatës Evropiane si dhe në masat konkrete që ka marrë për të garantuar zbatimin e vendimeve të formës së prerë të gjykatave vendëse. Komiteti i Ministrave ka vlerësuar në këtë proces të gjatë dhe të vështirë, bashkëpunimin e autoriteteve shqiptare dhe atyre të Këshillit të Evropës në procesin e hartimit dhe zbatimit të mekanizmit të kompensimit të pronave. Gjatë diskutimeve në Komitetin e Ministrave, nga sekretariati është vlerësuar rasti i Shqipërisë, si një histori suksesi që garanton funksionimin e procesit të ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës Evropiane, duke vlerësuar maksimalisht përpjekjet dhe rezultatet e dukshme që qeveria shqiptare ka bërë për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës". Njoftimi mbyllet: "Kompensimi i pronarëve tashmë është i garantuar dhe sipas përcaktimeve ligjore do të realizohet brenda afatit ligjor 10-vjeçar. Tashmë, për qytetarët të cilët prej vitesh kanë hasur ndryshime të shpeshta ligjore ose vendime, të cilat nuk janë ekzekutuar, kanë një mekanizëm efektiv, i cili siguron ekzekutimin e të drejtës së tyre të njohur për kompensim". Ministrja e Drejtësisë, Etilda Gjonaj reagoi për rezolutën e miratuar nga Komiteti i Ministrave të Këshillit për mbylljen e procesit të mbikëqyrjes të masave të përgjithshme për grupin e punës që lidhet me kompensimin e pronave. Në një reagim në "Twitter", ajo përshëndet vendimin e KiE, ndërsa shprehet se kjo rezolutë vjen si përgjigje dhe për opozitën, që veç retorikes politike s'ka dhënë asnjë zgjidhje për pronarët. "Qeveria Shqiptare është vlerësuar pasi ka përmbushur të gjitha masat lidhur me pronat, duke ofruar mbështetje politike, financiare e teknike që nga viti 2014 e në vazhdim. Vendimi i CoE është përgjigje dhe për opozitën, që veç retorikes politike, s'ka dhënë asnjë zgjidhje për pronarët", shkruan Gjonaj.




**REAGIMI**

"Qeveria shqiptare është vlerësuar pasi ka përmbushur të gjitha masat lidhur me pronat, duke ofruar mbështetje politike, financiare e teknike që nga viti 2014 e në vazhdim. Vendimi i CoE është përgjigje edhe për opozitën, që veç retorikes politike, s'ka dhënë asnjë zgjidhje për pronarët", shkruan Gjonaj.

"Bëhu pronar i tokës tënde", thirrja për fermerët

## Rama fton fermerët pa pronësi: Plotësoni dosjen deri më 31 dhjetor

Kryeministri Edi Rama me anë të një videoje informuese njoftoi dje se të gjithë fermerët që nuk kanë pronësi mbi tokën e tyre mund të paraqiten pranë njësive bashkiake për të plotësuar falas dosjen. Sipas Ramës, ata duhet t'u drejtohen njësive vendore për plotësimin e formularit falas deri në 31 dhjetor të këtij viti. Rama njofton se afati i fundit është 31 dhjetori i këtij viti. "Mirëmëngjesi dhe me këtë ftesë për të gjithë fermerët pa pronësi mbi tokën e tyre bujqësore, që të drejtohen pranë bashkisë apo njësisë së tyre administrative për të përfituar plotësimin falas të dosjes deri më 31 dhjetor, ju uroj një të diel të bukur!", shprehet z.Rama.




**DOSJA**

Kryeministri Edi Rama uroi dje ndjekësit për një ditë të mbarë, ndërsa u ka bërë thirrje fermerëve pa pronësi në tokën e tyre bujqësore që të plotësojnë dosjen falas brenda 31 dhjetorit të këtij viti.

Reagon mjeku: Keqardhje, sulmet të pabaza

## Denoncimi te Berisha: Shkon në spital për një puçërr, i heqin apendicitin

Ish-kryeministri Sali Berisha publikoi dje mesazhin e një qytetari dixhital, i cili ka denoncuar spitalin e Peshkopisë dhe mjekun që sipas tij është bashkëshorti i deputetes së PS, Almira Zebi Xhembulla. Në denoncimin e bërë publik te Berisha thuhej se djali 20-vjeçar shkoi për të kontrolluar një puçërr në shpinë, por kirurgu Gazmir Xhembulla e ka bërë operacion nga apendiciti. Një banor nga Dibra thotë se në spital është paraqitur më 20 shtator një 20-vjeçar për shkak të një puçrre në pjesën e shpinës dhe mjeku i ka këshilluar që t'i nënshtrohet operacionit, por kur është zgjuar, ka parë një plagë në pjesën e barkut. "Mjeku i ka thënë të hoqëm apendicitin se ti më the për apendicitin. Ka plasur sherri me familjarët e djalit dhe familja ka vajtur për kallëzim, por e kanë mbajtur të fshehur këtë rast budallallëk të mjekëve tanë. Drejtoria e spitalit është në dijeni dhe gjithë Peshkopia e di këtë budallallëk", thuhet në denoncimin në adresë të z.Berisha. I menjëhershëm ishte reagimi i vetë mjekut Gazmir Xhembulla, i cili në një status në "Facebook" shprehet tepër i indinjuar nga ngjarja. Ai shkruan se ndaj pacientit janë zbatuar rigorozisht të gjitha rregullat dhe procedurat dhe se çdo sulm ndaj tij ka të bëjë me punën e bashkëshortes. "Si mjek kirurg, me një eksperiencë mbi 20-vjeçare, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë, morale dhe profesionale, se ndaj pacientit E.S. janë zbatuar rigorozisht të gjitha rregullat dhe procedurat, sipas protokollit mjekësor në fuqi. Jam gati të mirëkuptoj shqetësimin e pacientit dhe familjarëve, por ndjej keqardhje të thellë kur shoh që një akuzë e pavend dhe aspak profesionale, është bërë sot nga një ish-mjek dhe ish-profesor i imi", shprehet mjeku Xhembulla.

**ORJOLA PAMPURI**

Duke reaguar mbi vendimin e Gjykatës së Shkodrës për lirimin e 7 mjekëve, deputetja e Partisë Demokratike, Orjola Pampuri tha dje se faktet vërtetuan se ata po kryenin detyrën e tyre.

STUDIO PËRMBARIMORE GJYQËSORE "KREON" me PËRMBARUESE GJYQËSORE SUELA METHOXHA
Dt. 25.09.2018 ora 16:00
Përfundon Ankandi i Parë për pasurite:
- Pasuria "Lokal nr.4" me sip.66 m2, me adresë L.13, Plazh Durrës.
Me çmim 66 000 Euro
- Pasuria "Lokal nr.5" me sip.43 m2, me adresë L.13, Plazh Durrës.
Me çmim 51 600 Euro
-Pasuria "Lokal nr.6" me sip.110 m2, me adresë L.13, Plazh Durrës
Me çmim 140 800 Euro
Ankandi Zhvillohet në zyrën e STUDIO PËRMBARIMORE GJYQËSORE "KREON", me adr: L.11, Blv.kryesor (ish kinma iliria) ,Kati-2, Durrës, Kontakt Cel 0682096575

# OPERACIONI ANTIDROGE
## ARRESTIMET

U shiste klientëve lëndë narkotike në lokal, ndalohet banakieri në Sarandë

# Kapet me 107 doza kokainë në Dhërmi, arrestohet Artan Agolli

*Operacioni antidrogë "Vjeshta" zbulon laboratorin e drogës*


Droga dhe armët e sekuestruara nga policia greke

**VLORE**

Një 48-vjeçar nga Korça, i cili jetonte në Dhërmi ka rënë në prangat e policisë pasi e kishte kthyer banesën në laborator ku paketohej, përpunohej e më pas shitej kokaina. Në kuadër të operacionit antidrogë të koduar "Vjeshta", policia e Vlorës ka sekuestruar 107 doza kokainë dhe para dhe ka arrestuar shtetasin Artan Agolli. Ndërkohë në Sarandë është kapur dhe arrestuar një tjetër shtetas, që shpërndante kokainë me doza. Bëhet fjalë për 42-vjeçarin Marjo Kola, pasi në lokalin ku punonte si banakier u gjetën 4 gramë lëndë narkotike e dyshuar si kokainë, të cilën ua shiste klientëve.

**OPERACIONI**

Seksioni për Hetimin e Narkotikëve pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Vlorë, në bazë të informacioneve të siguruara në rrugë operative, kanë organizuar, zhvilluar dhe finalizuar me sukses operacionin antidrogë "Vjeshta", në kuadër të të cilit u arrestua në flagrancë shtetasi Artan Agolli, 48 vjeç, lindur në fshatin Zvarisht, Korçë dhe banues në fshatin Dhërmi Vlorë. Sipas hetimeve me metoda speciale, u bë i mundur lokalizimi i vendndodhjes së personit dhe në mënyrë të mirorganizuar dhe profesionale u arrit kapja në kushtet e flagrancës e shtetasit Agolli, në godinën ku edhe jetonte përkohësisht në fshatin Dhërmi, Vlorë. Nga kontrolli i banesës, policia ka sekuestruar në cilësinë e provës materiale drogë, materiale të ndryshme dhe para të përfituara nga shitja e lëndës narkotike. Konkretisht janë sekuestruar 107 doza lëndë narkotike e dyshuar e llojit kokainë, 353.000 (treqind e pesëdhjetë e tre mijë) lekë të reja, 875 (tetëqind e shtatëdhjetë e pesë) euro, si dhe 100 (njëqind) dollarë, një automjet i markës "Mercedes Benz", një peshore elektronike, dy aparate celulare. Gjithashtu, në zbatim të planit të masave për kontrollin e territorit, për kapjen e personave në kërkim, atyre që qarkullojnë me armë zjarri, apo që trafikojnë lëndë narkotike, gjatë kontrolleve të ushtruara në territorin e qarkut Vlorë, nga Forca e Posaçme Operacionale me mbështetjen e FNSH, janë shoqëruar për verifikim 28 persona, kryesisht ata me precedentë penalë. Ndërkohë në Sarandë, policia arrestoi në flagrancë shtetasin Marjo Kola, 42 vjeç, banues në Sarandë, menaxher dhe banakier në një lokal. Kapja dhe arrestimi i tij u bë në lokalin ku punon, pasi gjatë kontrollit të ushtruar në banakun e këtij lokali, u gjetën dhe u sekuestruan 4 gramë lëndë narkotike e dyshuar si kokainë. Materialet iu referuan prokurorisë për veprime të mëtejshme.




**OPERACIONI**

Në kuadër të operacionit të koduar "Vjeshta", policia ka sekuestruar në banesën e shtetasit Artan Agollit drogë, materiale të ndryshme dhe para të përfituara nga shitja e lëndës narkotike. Konkretisht janë sekuestruar 107 doza lëndë narkotike e dyshuar e llojit kokainë, 353.000 (treqind e pesëdhjetë e tre mijë) lekë të reja, 875 (tetëqind e shtatëdhjetë e pesë) euro, si dhe 100 (njëqind) dollarë, një automjet i markës "Mercedes Benz", një peshore elektronike dhe dy aparate celulare.

**PUKË**

## Kapen me drogë në banesë, arrestohen dy pukjanë



Dy persona kanë rënë në pranga të policisë së Pukës, pasi gjatë kontrollit në banesë, efektivët kanë zbuluar një sasi droge. Mësohet se të arrestuarit janë Robert Cara dhe Zef Frroku. Sipas informacioneve paraprake, thuhet se droga ishte e fshehur në banesën e këtij të fundit. Ende nuk dihet sasia e drogës së sekuestruar, ndërkohë policia dhe grupi hetimor po punojnë për zbardhjen e plotë të këtij rasti.

## Kontroll blic në burgje, kapen celularë e drogë, procedohen penalisht 13 persona

2223 Elmije Mehmet Xhaferri
2224 Emin Selim Dajti
2225 Emin Nezir Shabanaj
2226 Emine Arif Pellumbi
2227 Erion Gezim Kabili
2228 Ervin Shaban Mansaku
2229 Fadil Tahir Muçaj
2230 Fatime Ismail Gjediku
2231 Fatmir Nuri Elezi
2232 Fatmir Beqir Flora
2233 Fatmir Mexhit Gjikola
2234 Fatmir Sadik Kurcani
2235 Fatmir Shyqyri Kurti
2236 Fatmir Bajram Lika
2237 Fatmir Jakup Lila
2238 Fatmir Aqif Popshini
2239 Fatmir Jakup Visha
2240 Fatos Nuri Bumja
2241 Fatos Sinan Kamberi
2242 Fejzulla Bajram Koçi
2243 Fezulla Islam Kamberi
2244 Fiqëri Jakup Lila
2245 Flamur Mehmet Luga
2246 Florentina Shkelqim Shabanaj
2247 Gani Nezir Visha
2248 Gazmir Xhemal Kiçi
2249 Gazmir Muharrem Pellumbi
2250 Gentjan Asllan Lika
2251 Gezim Ibrahim Dedia
2252 Gezim Hasan Gjiku
2253 Gezim Rexhep Tarja
2254 Habibe Qamil Elqeni
2255 Hajdin Osman Kuka
2256 Halil Kadri Gjoka
2257 Halil Fejzulla Heta
2258 Halil Hasan Popshini
2259 Hamide Hysen Kamberi
2260 Hamit Naim Visha
2261 Hamza Islam Gjiku
2262 Hamza Qazim Mali
2263 Hamza Gezim Shkopi
2264 Hasan Dervish Elqeni
2265 Hasan Rexhep Leta
2266 Hasan Mete Mali
2267 Hasan Destan Meta
2268 Hatixhe Sali Dajti
2269 HAXHI ISLAM TARJA
2270 Haxhi Rahman Visha
2271 Hazbi Neki Feza
2272 Hazbi Muharrem Muçaj
2273 Hekuran Ymer Cani
2274 Hekuran Rexhep Leta
2275 Hider Qazim Visha
2276 Hydajet Ismail Kanina
2277 Hysen Ibrahim Leta
2278 Hysni Shaban Sula
2279 Ibrahim Fadil Dedia
2280 Ibrahim Besim Hidri
2281 Ibrahim Abdi Mali
2282 Ibrahim Seit Popshini
2283 Ibrahim Hajdin Xhaferri
2284 Ilir Nuri Kabili
2285 Ilir Ramiz Mema
2286 Ilir Bajram Nasufaj
2287 Ilir Ismail Totri
2288 Ilir Sali Visha
2289 Ilmi Xhelal Kaca
2290 Ilmi Hamza Mali
2291 Indrit Ahmet Gjikola
2292 Iraldo Mehmet Kacani
2293 Isa Mehdi Visha
2294 Isen Hamdi Iskoli
2295 Islam Ramazan Deda
2296 Islam Mahmud Hysa
2297 Islam Sali Llusha
2298 Islam Ramazan Moqi
2299 Ismail Asllan Lika
2300 Isuf Ibrahim Hasa
2301 Jakup Ramazan Hoxha
2302 Jakup Sulejman Shabanaj
2303 Jashar Isuf Disha
2304 Jemin Kalosh Kuka
2305 Jorgo Daut Alla
2306 Kalem Daut Lila
2307 Kalosh Rexhep Tarja
2308 kujtim shefqet dedia
2309 Kujtim Asllan Elqeni
2310 Kujtim Sali Hida
2311 Kujtim Muharrem Hidri
2312 Kujtim Selman Vogli
2313 Liman Besim Hidri
2314 Liman Mustafa Kuka
2315 Lirije Sali Deda
2316 LUAN Haki PËLLUMBI
2317 Luftim Sabri Bumja
2318 Luftim Musa Elqeni
2319 Lulzim Hider Deda
2320 Lulzim Mexhit Kodra
2321 Lulzim Hysen Muça
2322 Lutfi Asllan Kabili
2323 Lutfi Jakup Visha
2324 Mahmut Rexhep Kurcani
2325 Mandi Fadil Qorri
2326 Mehmet Qazim Mema
2327 MEHMET Refik PËLLUMBI
2328 Mehmet Veli Ruçi
2329 Mehmet Hysen Ymeri
2330 Merjeme Ismail Dajti
2331 Mexhit Selim Kurcani
2332 Mezan Haxhi Kuka
2333 Mirushe Latif Elqeni
2334 Muharrem Kadri Gjoka
2335 MURAT Hamid PËLLUMBI
2336 Musa Rexhep Gjeçi
2337 Myslim Avdi Flora
2338 Naim Sabri Çuni
2339 Naim Ibrahim Dedia
2340 Naim Ismail Elqeni
2341 Naim Bajram Hidri
2342 Naim Nuri Hoxha
2343 Naim Shaban Ruçi
2344 Naim Hamid Visha
2345 Namir Ymer Gjikola
2346 Namir Xhan Mema
2347 Naxhie Rexhep Huta
2348 Nazmi Muharrem Deliu
2349 Nazmi Islam Gjiku
2350 Nazmi Ramiz Gjoka
2351 Nazmi Osman Kuka
2352 Nazmi Hasan Popshini
2353 Nazmi Ymer Visha
2354 Ndriçim Mehmet Jamaku
2355 Ndriçim Nuri Kuka
2356 Ndriçim Ermal Sula
2357 Nertil Kujtim Dajti
2358 Nexhmi Ali Dedja
2359 Nexhmi Mustafa Muçaj
2360 Nezir Shefqet Dedia
2361 Nezir Ramazan Flora
2362 Nezir Adem Meta
2363 Nuri Sul Balliu
2364 Nuri Hysen Çuni
2365 Osman Shaban Deda
2366 Osman Rexhep Mansaku
2367 Pashame Ibrahim Hoxha
2368 Pellumb Adem Mansaku
2369 Petrit Musa Balliu
2370 Petrit Mehmet Beka
2371 Petrit Asllan Deda
2372 Petrit Ismail Gjikola
2373 Petrit Adem Hajdini
2374 Petrit Islam Kamberi
2375 Petrit Sabri Loka
2376 Petrit Njazi Pellumbi
2377 Petrit Fadil Qorri
2378 Pranvera Hasan Feza
2379 Qamil Ibrahim Deda
2380 Qazim Ali Aliu
2381 Qazim Shefqet Bumja
2382 Qazim Mehmet Gjoni
2383 Qerim Qazim Mema
2384 Qerim Ramazan Pëllumbi
2385 Ragip Ramazan Leta
2386 Ramazan Mehmet Beka
2387 Ramazan Selim Duka
2388 Ramazan Xhafer Hysa
2389 Ramazan Hysen Mulla
2390 Ramazan Fadil Qorri
2391 Ramazan Mehmet Rama
2392 Refat Qamil Gjikola
2393 Refik Selim Kurti
2394 Reshid Ruç Cani
2395 Reshit Qamil Hidri
2396 Resmi Zenel Lila
2397 Rexhep Beqir Beka
2398 Rexhep Rexhep Jamaku
2399 Rexhep Ramazan Nasufi
2400 Riza Beqir Meta
2401 Riza Njazi Sita
2402 Rrahman Haxhi Visha
2403 Rrushdije Ismail Haxhiu
2404 Rudina Asllan Hoxha
2405 Ruzhdi Hasan Kiçi
2406 Sabaudin Shkelqim Shabanaj
2407 Sabri Musa Balliu
2408 Sabri Osman Huta
2409 Sadik Ismail Dajti
2410 Saidih Hasan Rexha
2411 Saimir Nuri Kabili
2412 Saimir Ramazan LLani
2413 Sajmir Asllan Visha
2414 Sajrije Mustafa Balliu
2415 Sali Avdi Jamaku
2416 Sami Shaban Deda
2417 Sami Murat Kurti
2418 Sami Hysen Moqi
2419 seid haxhi beka
2420 Seid Sabri Hidri
2421 selim ali gjoli
2422 Selim Beqir Sala
2423 Selman Haxhi Deda
2424 Selman Hajdar Gjoni
2425 Shaban Ramazan Hajdini
2426 Shaban Rexhep Tarja
2427 Shefqet Haxhi Flora
2428 Shefqet Xhelal Visha
2429 Shkelqim Aqif Beka
2430 Shkelqim Sinan Kamberi
2431 Shkelqim Enver Mali
2432 Shkelqim Hajdar Muça
2433 Shkelqim Bajram Nasufaj
2434 Shkelqim Mehmet Xhaferri
2435 Shkëlqim Selim Shkopi
2436 SHKËLQIM Liman VISHA
2437 Shkelzen Ramazan Molla
2438 Shpetim Hysen Dervishi
2439 Shpetim Hasan Gjiku
2440 Shpetim Bajram Hoxha
2441 Shpetim Destan Meta
2442 Shpetim Jakup Visha
2443 Shpresa Ibrahim Visha
2444 Sinan Abdi Kurcani
2445 Sokol Ramazan Haka
2446 Sulejman Hasan Gjiku
2447 Sulejman Xhavid Kodra
2448 Sulejman Ramazan Likalla
2449 Tahir Veli Ruçi
2450 Tahir Zenun Tarja
2451 Tahir Sinan Visha
2452 Tasim Mustafa Totri
2453 Taulant Besim Ymeri
2454 Tixhe Ahmet Muçaj
2455 Vait Naim Hidri
2456 Vehbi Isuf Jusufi
2457 Vehbi Qazim Kamberi
2458 Vehbi Selim Kurti
2459 Veli Elez Daka
2460 Xhabirr Mehdi Lila
2461 Xhavit Isuf Lila
2462 Xhelal Aqif Feza
2463 Xhemal Asllan Heta
2464 Xhemal Qamil Meta
2465 Xhevahir Aqif Beka
2466 Xhevahir Fadil Cani
2467 Xhevahir Asllan Mema
2468 Xhevahir Hysen Muça
2469 Xhevdet Ymer Gjikola
2470 Ylber Ymer Duka
2471 Ylli Haxhi Beka
2472 Ylli Mexhit Kodra
2473 Ylmi Hajdar Flora
2474 Ylmi Ramazan Leta
2475 Ymer Asllan Elqeni
2476 Ymer Haxhi Flora
2477 Zenel Abaz Elqeni
2478 Zenel Ali Flora

**Zall Herr**

2479 Adriatik Habib Neli
2480 Agim Bajram Baja
2481 Agim Mehmet Gjiku
2482 Agim Ibrahim Lezi
2483 Agim Osman Mera
2484 Agim Abdi Nika
2485 Agron Xhevat Beshiri
2486 Albert Haki Hithi
2487 Alfred Bajram Baja
2488 Altin Mustafa Kodra
2489 Anton Ndue Cenaj
2490 Ardian Xhemal Cmeta
2491 Arjan Ali Hoxha
2492 Arjan Vath Maloku
2493 Armando Agim Tufa
2494 Artan Qerim Bytyçi
2495 Bajram Bajtulla Fusha
2496 Bajram Abdulla Lami
2497 Banush Rrahman Selita
2498 Bashkim Islam Hida
2499 Bashkim Riza Koka
2500 Bashkim Kadri Mënalla
2501 Bashkim Sulejman Xhepa
2502 Behar Xhemal Cmeta
2503 Bejtulla Ismail Isaku
2504 Bekim Halil Muça
2505 Besim Ibrahim Lezi
2506 Besjan Nazmi Tusha
2507 Besmir Halim Rrahmani
2508 Bujar Rrustem Shatri
2509 Dafina Marash Marku
2510 Dan Halit Vladi
2511 Dashamir Ramiz Allushi
2512 Dashamir Habib Neli
2513 Dashamire Petrit Neli
2514 Dashnor Bejtulla Fusha
2515 Dritan Xhelal Kërtuka
2516 Durim Xhevat Qefalia
2517 Edmond Muharrem Bardhi
2518 Edmond Ramazan Meta
2519 Edmond Ali Vathi
2520 Edmond Skender Xhaja
2521 Fatjon Bajram Kodra
2522 Fatmir Hasan Gjiku
2523 Fatmir Ahmet Taka
2524 Flamur Gani Metani
2525 Flora Musa Meta
2526 Florim Kadri Doçi
2527 Gani Asllan Brata
2528 Gazmir Xhemal Metani
2529 Halit Ramadan Bruka
2530 Haxhi Ramazan Hyka
2531 Ibrahim Ramazan Kasmi
2532 Ilir Hasan Çeka
2533 Ilir Sinan Lozi
2534 Ilir Shaqir Muça
2535 Ilir Xhemal Tufa
2536 Islam Gani Elezi
2537 Kasëm Zenel Hida
2538 Kol Nik Palushi
2539 Kujtim Nuhi Islamaj
2540 Kujtim Nezir Kaceli
2541 Kujtim Hamit Kodra
2542 Kujtim Hamza Lami
2543 Kujtim Besim Metani
2544 Lefter Rexhep Qefalia
2545 Lindeditë Mhill Bala
2546 Lindita Hamid Grifsha
2547 Lindita Rustem Meshi
2548 Lulash Ndue Keçani
2549 Lulzim Besim Dushku
2550 Lulzim Hasan Muça
2551 Lutfi Vesel Metani
2552 Mirash Pjetër Syla
2553 Murat Haxhi Hoxha
2554 Naim Sulejman Xhepa
2555 Nazif Sefer Domi
2556 Nazmi Shaqir Muça
2557 Ndriçim Shefqet Ullini
2558 Nexhmije Hamza Cidri
2559 Pëllumb Mus Gojani
2560 Perparim Sherif Istrefi
2561 Petrit Zenel Hoxha
2562 Petrit Ramazan Zogu
2563 Qemal Rrahman Marku
2564 Qerim Sefer Hoxha
2565 Rahman Xhemal Molla
2566 Rakip Shefit Bruka
2567 Ramiz Jusuf Tufa
2568 Refik Vath Baqoshi
2569 Refik Rakip Bruka
2570 Rexh Mus Gojani
2571 Rexhep Xhemal Lozi
2572 Roland Mustafa Neziri
2573 Ronaldo Agim Tufa
2574 Rozalinda Nazmi Tusha
2575 Sali Ahmet Marku
2576 Shaban Abaz Halilja
2577 Shani Qazim Koldashi
2578 Shaqir Vesel Hida
2579 Sherif Ibrahim Xhaja
2580 Shkelqim Muse Mici
2581 Shkëlqim Selman Karaj
2582 Shpetim Hidër Dani
2583 Shpëtim Kadri Doçi
2584 Shpëtim Shaqir Todaj
2585 Skënder Hamdi Xhixha
2586 Vladimir Preg Doçi
2587 Vllashi Llazar Çuko
2588 Vullnet Xhevat Qefalia
2589 Xhemal Reshit Cmeta
2590 Xhemal Ibrahim Lami
2591 Xhemali Fadil Durmishi
2592 Xhevahir Din Muneka
2593 Xhevahir Ramiz Shehu
2594 Xhevit Hysen Islamaj
2595 Ylber Gezim Meta
2596 Ymer Ramazan Baqoshi
2597 Zyhdi Ramazan Hoxha
2598 Zyhdi Hajrulla Metani
2599 Zyhdi Ramiz Qefalia

**Akuza: Morën 1 mijë euro nga Ndoc Tarja për certifikatë pronësie**

# Korrupsioni në Hipotekën e Shkodrës, gjykata lë në burg 3 nga të arrestuarit



**PROKURORIA E TIRANES**
Pas zbulimit të një rasti korrupsioni në Prokurorinë e Tiranës, ku për ndryshimin e akuzës së dy të pandehurve kërkohej 2 mijë euro, Krimet e Rënda dhanë dje masën "arrest me burg" për avokaten Donada Lepenica. Po ashtu është dhënë masa "arrest me burg" për shtetasin Yzeir Bala, ndërsa për bashkëshortjen e tij Megi Naksi është dhënë masa 'arrest shtëpie'.

**SHKODER** - Gjykata e Shkallës së Parë në Shkodër ka vendosur ditën e djeshme masën e sigurisë "arrest me burg" për tre prej shtetasve të ndaluar dhe të arrestuar që dyshohen për korrupsion në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive në Shkodër dhe "arrest shtëpie" për një tjetër. Në këtë mënyrë, shkalla e parë la në burg dy të ndaluarit Mirjam Bletaj, ish-jurist i Hipotekës së Shkodrës dhe Sokol Tirana, i dyshuar si sekser. Në "arrest me burg" u la edhe shtetasi tjetër, Johan Zefi, i dyshuar si sekser, ndërsa Ndoc Tarajt personi i cili do përfitonte certifikatën e pronësisë përmes korrupsionit iu dha masa e sigurisë "arrest shtëpie", e kërkuar nga vetë prokuroria. Dy të fundit janë arrestuar në flagrancë në një lokal të afërsi të Hipotekës së Shkodrës. Sipas prokurorisë, shtetasi Ndoc Taraj, pronar i një objekti ishte i gatshëm që të paguante një mijë euro për të përfituar në mënyrë të përshpejtuar certifikatën e pronësisë nga Hipoteka e Shkodrës. Në këtë mënyrë, organi i akuzës dyshon se Taraj do i paguante shumën e parave shtetasit Johan Zefi, i cili do t'ia dërgonte Sokol Tiranës dhe këta të dy në rolin e sekserit, do t'ia jepnin në fund ish-juristit Mirjam Bletaj për të bërë të mundur më pas nxjerrjen e certifikatës së pronësisë në mënyrë të përshpejtuar. Shtetasit që u lanë në "arrest me burg" gjatë seancës për dhënien e masës së sigurisë në Gjykatën e Shkallës së Parë në Shkodër mohuan akuzat ndaj tyre, duke thënë se nuk kanë lidhje me korrupsionin. Ish-juristi Bletaj, dy personat e dyshuar si sekserë Johan Zefi dhe Sokol Tirana dhe pronari i objektit, Ndoc Taraj hodhën poshtë çdo dyshim të prokurorisë. Në këtë mënyrë, pala mbrojtëse kërkoi një masë lehtësuese për katër shtetasit, për shkak se nuk janë persona të rrezikshëm dhe se prokuroria nuk ka prova të mjaftueshme për t'i mbajtur me masë shtrënguese. Në fund, gjykata e shkallës së parë vendosi që t'i lërë në "arrest me burg" tre prej tyre dhe cilësoi të ligjshëm ndalimin dhe arrestimin. Sipas burimeve, pritet që në Hipotekën e Shkodrës të ketë edhe disa shkarkime të tjera punonjësish, kjo edhe në kuadër të një deklarate të ministres së Drejtësisë, Etilda Gjonaj, për korrupsionin në zyrat e hipotekave. Se.Ni.

Operacioni "OAZ", të pandehurit kryenin aktivitet kriminal në trafikun e drogave dhe gjobëvënies

# 9 të arrestuarit e fisit Bajri, përballë Gjykatës së Krimeve të Rënda

## *Hetimet, anëtarët e këtij grupi, autorë të dy vrasjeve në Shkodër*

Nëntë anëtarët e fisit Bajri, të arrestuar në sajë të operacionit "OAZ" pritet të dalin përballë Gjykatës së Krimeve të Rënda në orën 14:00, ku do verifikohet masa e sigurisë arrest me burg e dhënë në mungesë të tyre. Të dielën, Gjykata e Krimeve të Rënda ka bërë njoftimet drejt komisariateve ku mbahen të arrestuarit, ndërsa njoftim është bërë edhe drejt burgut të Shën Kollit, atje ku mbahen të izoluar 3 të arrestuarit pas operacionit të zhvilluar në javën e parë të shtatorit në Shkodër. Policia e Shtetit në bashkëpunim me Prokurorinë për Krimet e Rënda pas 6 muajsh hetimesh ka finalizuar operacionin "Oaz", duke shkatërruar grupin e Bajrave me 11 të arrestuar në Tiranë, Shkodër e Roterdam dhe dy persona të shpallur në kërkim. Në sajë të hetimeve të prokurorisë, ka rezultuar se grupi kryente aktivitet kriminal brenda dhe jashtë vendit, kryesisht në trafikun e drogave të rënda, gjobëvënie dhe fiksimin e ndeshjeve, por edhe vepra të tjera të rënda penale. Bazuar në dhjetëra orë përgjime, informacione të shkëmbyera me partnerët dhe veprimeve proaktive në terren, prokuroria ka dokumentuar deri tani se anëtarë të këtij grupi janë autorë të dy vrasjeve të ndodhura kohë më parë në Shkodër. E para është vrasja e Arben Tuzit në shkurt të vitit 2001, ndërsa tjetra vrasja e 15-vjeçares Fabiola Bajri në vitin 2002, bashkëjetuese e njërit prej të arrestuarve. Vrasja e së resë është raportuar fillimisht si vetëvrasje, ndonëse vajza ishte qëlluar me një plumb, ndërsa arma pranë saj u gjet me fishek gati për qitje. Mes të arrestuarve janë dhe Safet Bajri dhe vëllai i tij Ilir Rustemi, të konsideruar si njerëzit kryesorë të grupit. Policia nuk mundi të arrestojë Enver Bajrin, i cili konsiderohet si drejtuesi i grupit kriminal, të shkatërruar në Shkodër. 45-vjeçari është shpallur në kërkim bashkë me një tjetër person me inicialet N.H. dhe ka dyshime se fshihet jashtë Shqipërisë.




**BERISHA**
Ish-kryeministri Sali Berisha ka publikuar të dhëna sipas tij, të komunikimeve telefonike të kryeministrit Rama me Behar Bajrin, një nga anëtarët e grupit kriminal të Shkodrës, pjesëtarë të të cilit u arrestuan nga policia. Sipas Berishës, bisedat zhvillohen për mbrojtjen e Safet Bajrit në mediat proqeveritare, i cili rezulton si një nga personat më të kërkuar në Belgjikë.

**SALIANJI**
Deputeti i PD, Ervin Salianji akuzoi ministrin e Jashtëm, Ditmir Bushati, se me porosi të Edi Ramës ka bashkëpunuar me Bajrët në zgjedhje. Salianji u shpreh se Rama i ka kërkuar grupit Bajraj, nëpërmjet Ditmir Bushatit që të shtojnë numrin e deputetëve të PS në qarkun Shkodër sipas "mënyrës së tyre" dhe në këmbim u ka ofruar garanci për të drejtuar ata të gjitha interesat në Shkodër.



# Konflikte për pronën, dhunohet barbarisht nga kunati dhe djemtë e tij 55-vjeçarja në Durrës

**DURRËS** - Një 55-vjeçare është rrahur barbarisht nga kunati i saj, Medi Koleci, së bashku me 2 djemtë e tij Alket dhe Admir Koleci për motive pronësie në Durrës. Bëhet fjalë për Qefsere Koleci, e cila për shkak të gjendjes së rëndë u transportua për ndihmë të specializuar në spitalin e traumës në kryeqytet. Shkak i këtij konflikti ishte një sipërfaqe toke, e cila shërbente si rrugë. Prej vitesh 61-vjeçari Medi Koleci e kishte përvetësuar këtë hapësirë duke e mbjellë me ullinj. Pas ankesës së 55-vjeçares në autoritetet vendore, INUK i Durrësit, policia dhe administratori i Manzës ndërhynë me fadroma duke e kthyer rrugën në gjendjen e mëparshme. Duke qenë se 61-vjeçari Medi Koleci së bashku me 2 djemtë e tij, Alket dhe Admir Koleci e kundërshtuan këtë vendim, ata u shoqëruan në polici duke u mbajtur disa orë në komisariat. Menjëherë sapo kanë dalë nga komisariati, ata kanë shkuar tek prona për të cilën ishin në konflikt dhe kanë rrahur barbarisht 55-vjeçaren. Në ikje ata kanë prerë edhe disa pemë ulliri në pronësi të saj. Ndërkohë, policia e Durrësit ka shpallur në kërkim 61-vjeçarin Medi Koleci së bashku me dy djemtë e tij me akuzën e "Vrasjes për shkak të marrëdhënieve familjare, e mbetur në tentativë e kryer në bashkëpunim".

## Ndihmoi një të aksidentuar, vritet 22-vjeçari shqiptar në SHBA

**SHBA** - Një 22-vjeçar shqiptar nga Devolli është përplasur për vdekje në një nga rrugët e Floridës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, teksa po kthehej nga shkolla ditën e enjte. I riu shqiptar, në lëvizje e sipër në autostradë ndaloi për të ndihmuar një person tjetër, i cili ishte aksidentuar nga një motor, por më pas, Dhimitri Andoni u përplas nga një kamion. Mjeti po drejtohej nga një përdorues droge, ku sipas raportimeve, e kishte paguar lirinë për 100.000 mijë dollarë. Pas përplasjes, drejtuesi i kamionit i rrëmbeu makinën të riut, ndërsa kamionçinën e la në një cep të rrugës duke ia mbathur nga vendi i aksidentit. Sipas raportimeve, policia ka bërë të mundur arrestimin e drejtuesit të kamionçinës, Dana Byrd, i cili goditi për vdekje shqiptarin nga Devolli.

Mediat e huaja: "Shuttle diplomacia", rruga për të pasur marrëveshje brenda pranverës

# Dialogu Kosovë-Serbi, SHBA pjesë aktive në tetor

## *Kryeministri kosovar, Haradinaj, vizitë në Amerikë*

Ndërohë që nuk ësh të arritur ende një marrëveshje përfundimtare mes Kosovës dhe Serbisë, përfaqësuesit e Shteteve të Bashkuara të Amerikës së shpejti do të përfshihen më aktivisht në ndërmjetësimin në mes të Beogradit e Prishtinës në negociata. Siç shkruan gazeta e Beogradit "Danas", kjo përfshirje do të zhvillohet përmes "shuttle diplomacisë" në bisedat me zyrtarët më të lartë në kryeqytetet e Serbisë e të Kosovës. Siç kanë thënë burime të kësaj gazete, SHBA-ja po pret përfundimin e referendumit në Maqedoni, të caktuar për 30 shtator dhe pastaj do t'i shtojë aktivitetet. "Qëllimi i SHBA-ve është që me zhvillimin e 'shuttle diplomacisë' t'i afrojë qëndrimet e Beogradit e të Prishtinës me synimin që të arrihet teksti kornizë i marrëveshjes për Kosovën, në mënyrë që dokumenti final të nënshkruhet në pranverën e vitit të ardhshëm. Pritet që deri më atëherë, kryetari serb, Vuçiç dhe ai kosovar Thaçi do t'ia dalin ta arrijnë përkrahjen e qeverive dhe të parlamenteve të veta dhe që në opinionin e të dy vendeve të krijohet klima për përkrahjen e korrigjimit ë kufijve në marrëveshjen finale", kanë thënë diplomatë, të cilët "danas" nuk i identifikon, raporton "Express". Nga ana tjetër, kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj ka udhëtuar ditën e djeshme për në SHBA për një vizitë zyrtare në Nju Jork dhe Uashington, ku do të zhvillojë kontakte me zyrtarë të lartë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Në kuadër të vizitës në Nju Jork, kryeministri Ramush Haradinaj do të zhvillojë takime me liderë dhe përfaqësues të ndryshëm të shteteve, që do të jenë pjesëmarrës në zhvillimin punimeve të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së dhe do të kërkojë mbështetjen e të gjithëve që Kosova të jetë pjesë e barabartë e komunitetit ndërkombëtar. "Kosova është e angazhuar që të dëshmojë aftësinë e vet për të qenë kontribuuese në paqen dhe progresin e përgjithshëm global", ka thënë kryeministri Ramush Haradinaj. Prezantimi i të arriturave të vendit, tërheqja e investimeve të huaja direkte, fuqizimi i marrëdhënieve bilatarale me shtetet pjesëmarrëse, takime me homologë nga shtetet europiane do të jenë pjesë e agjendës së kryeministrit. Në fokus të vizitës në SHBA, kryeministri Haradinaj do të qëndrojë edhe në Uashington, ku pritet të ketë takime bilaterale me senatorë e kongresmenë dhe personalitete të tjera me influencë në SHBA. Në takime pritet të diskutohet për thellimin e bashkëpunimit dhe partneritetit të shtetit të Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës. "Amerika është partneri strategjik i Kosovës dhe raportet e zhvilluara deri tani do t'i thellojmë në vazhdimësi", ka thënë kryeministri Ramush Haradinaj. Ai do të zhvillojë aktivitete edhe me komunitetin shqiptar të Amerikës, që ka luajtur rol të rëndësishëm në të kaluarën për ndërkombëtarizimin e çështjes së Kosovës, por edhe në proceset nëpër të cilat aktualisht po kalon vendi.



**DIPLOMATËT E SHBA-ve**

"Qëllimi i SHBA-ve është që me zhvillimin e 'shuttle diplomacisë' t'i afrojë qëndrimet e Beogradit e të Prishtinës, me synimin që të arrihet teksti kornizë i marrëveshjes për Kosovën, në mënyrë që dokumenti final të nënshkruhet në pranverën e vitit të ardhshëm".


Fibank
Cilësia vjen e para

**Fibank Albania - ndër bankat më aktive në kredidhënie**

**Fibank Albania** është një nga bankat më aktive për kredidhënien si për individë edhe për biznese me kushtet më të favorshme të mundshme, të përshtatura ndaj klientit sipas specifikave përkatëse.

Norma e interesit për kreditë fillon nga 1.9% të kombinuara me fleksibilitet në kërkesën e dokumentacionit dhe përshtatjen e kushteve sipas nevojave të klientit. Nuk aplikohet Sigurimi i Jetës për të gjitha llojet e kredive. Në rastin e kredive hipotekore nuk është e domosdoshme që kolaterali të jetë në emër të kredimarrësit. Këto kushte hapin plot mundësi të mira për këdo që ka dëshirë të marrë një financim për qëllimet e tij.

**Fibank** ofron fleksibilitet në planin e investimit dhe mbulimin me kolateral duke financuar edhe 100% të vlerës së investimit për klientë me të ardhura të qëndrueshme, historik të mirë të ripagimit të kredisë dhe kolateral të pranueshëm.

**Fibank Albania** po zbaton intensivisht strategjinë e saj të zgjerimit të degëve në të gjithë vendin dhe rritjen e numrit të stafit në shërbim të klientëve pa lënë mënjanë dizenjimin e produkteve në përputhje me strategjinë e të qenit tepër dinamikë në shfrytëzimin e mundësive të tregut. Skuadra **Fibank** është e dedikuar në rritjen e bazës së klientelës, duke i shërbyer çdo klienti me cilësi, shpejtësi dhe produkte sipas nevojave dhe mundësive të tyre.


**Ministri i Brendshëm: Do parandalojmë çdo lloj presioni**

## Referendumi për emrin e Maqedonisë, Gjeorge Ivanov: S'do të votoj më 30 shtator

Vetëm një javë para referendumit në Maqedoni, janë bërë paraprgatitjet për atmosferën e 30 shtatorit. Autoritetet vendëse janë vënë në gatishmëri maksimale për të parandaluar çdo lloj ndërhyrjeje, që synon dështimin e referendumit për marrëveshjen me Greqinë për emrin. Në një konferencë për shtyp, ministri i Brendshëm, Oliver Spasovski, njoftoi se ka urdhëruar policinë të reagojë ndaj çdo përpjekjeje për të penguar qytetarët të votojnë. "Maqedonia është vend i lirë demokratik me sjellje evropiane. Çdo lloj presioni, kërcënimi ose shantazhi për votimin do të parandalohet dhe sanksionohet në përputhje me ligjin. Kjo vlen edhe për aktivitetet 'online'". Shefi i kundërzbulimit maqedon, Goran Nikolovski thotë se agjencisë që drejton po heton mbi dyshimet se përpjekjeve për dështimin e referendumit i është bashkuar edhe Moska. "Kemi konstatuar aktivitete që synojnë reduktimin e pjesëmarrësve në referendum, dështimin e referendumit, çka mund të shkaktojë një rrjedhojë ngjarjesh të tjera. Veç të tjerave, kemi konstatuar përhapje të lajmeve të rreme e propagandistike". Ndërkaq, pavarësisht se opozita zbuti qëndrimin e saj kundër referendumit, duke ndalur thirrjet për bojkot, presidenti Gjorge Ivanov, i cili vjen prej rradhëve të saj tha se nuk do të votojë më 30 Shtator. Sakaq, ambasadori francez në Shkup befasoi me deklaratën e tij kur tha se nëse maqedonasit nuk pranojnë emrin Maqedoni e Veriut, ata do të izolohen si Koreja e Veriut. Presidenti Gjorge Ivanov gjatë takimit me Diasporën e Bashkuar të Maqedonisë në Detroit të SHBA-ve ka bërë të ditur se nuk do të votoj në referendumin e 30 shtatorit. "Dy herë kam fituar besimin e qytetarëve për të mos lejuar ndryshime të Kushtetutës, me qëllim ndryshimin e emrit kushtetues. Kam fituar besimin që të mos pranoj idetë dhe sugjerimet që rrezikojnë identitetin kombëtar, të veçantën e kombit maqedonas, gjuhën maqedonase dhe modelin e Maqedonisë për bashkëjetesë. Unë nuk heq dorë nga premtimi im. Prandaj, më 30 shtator, nuk do të dal për votim", porositi presidenti Gjorge Ivanov nga Detroiti, njoftojnë nga zyra e presidentit. "Çdo qytetar - tha Ivanov - ka të drejtën të vendosë se si do të veproj në referendum, të dalë të votojë, ose të bojkotojë".

Life pages
GAZETA SHQIPTARE
Suplement
E hënë 24 Shtator 2018 REDAKTOR: VOLTIZA DURO

## MJEKU POPULLOR



Ylli Merja: Efektet e mrekullueshme të hithrës në organizëm

## 11 KESHILLA



Si të parandaloni gjendjen e ankthit

# Gentian Stroni:



- Mjeku infeksionist: Fëmijët dhe të moshuarit, më të predispozuarit nga virozat e stinës

# Rreth 100 pacientë, në dyert e Infektivit çdo ditë

"Kujdes, mos harroni të vaksinoheni kundër gripit!"

• Kombinimi i veçantë i frutave, avokados e spinaqit. Si të pastroni mëlçinë me vajin e ullirit

**Mjeku infeksionist:** Fëmijët dhe të moshuarit, më të predispozuarit nga virozat e stinës

# Gentian Stroni:

# Rreth 100 pacientë, në dyert e Infektivit çdo ditë

## "Kujdes, mos harroni të vaksinoheni kundër gripit!"



Mjeku infeksionist, Gentian Stroni

Voltiza Duro

Rreth 100 persona të prekur nga virozat paraqiten çdo ditë pranë spitalit Infektiv në Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza" në kryeqytet. Me ardhjen e stinës së vjeshtës e ndryshimin e klimës, pacientët paraqesin probleme të traktit respirator e drejtohen për ndihmë pranë mjekut të lagjes apo në QSUT. Në një intervistë për suplementin "Life Pages" në "Gazeta Shqiptare", mjeku infeksionit Gentian Stroni tregon se deri më tani situata është e qëndrueshme, por thekson se fëmijët, të moshuarit dhe personat me imunitet të dobët janë më të predisposuar për t'u prekur nga virozat. Sipas mjekut, gripi është një nga format më të rënda të virozave të stinës. Statistikat tregojnë se në Europë ka pasur rreth 170 mijë vdekje çdo vit nga gripi, 22 milionë raste të rënda dhe rreth 3.5 milionë hospitalizime. Infeksionisti Stroni i bën thirrje popullatës që të vaksinohet sa më shpejt për të parandaluar prekjen nga viruset e gripit. Viruset e gripit janë në ndryshim të vazhdueshëm, prandaj vaksinimi rekomandohet çdo vit. Nevojiten rreth 2 javë pas marrjes së vaksinës derisa të zhvillohet mbrojtja, e cila zgjat rreth 1 vit.

**Me ardhjen e stinës së vjeshtës dhe përhapjen e virozave, si paraqitet situata në spitalin e Infektivit në QSUT?**

Nëse do diskutojmë për këtë stinë, kemi relativisht një rënie të sëmundshmërisë, në krahasim me periudhën e beharit. Në këtë të fundit, veçanërisht në gusht kemi pasur një ritëm shumë të lartë të infeksioneve të traktit gastro-intensinal. Praktikisht mund të themi që kemi një situatë deri diku stabël me disa shifra jo të larta, në krahasim me periudhën e gushtit (shkonte deri në 150 raste në ditë vetëm në spitalin e Infektivit në QSUT). Tani me ardhjen e vjeshtës, kemi rreth 90-100 raste në ditë, raste të cilat nuk janë të gjitha problematike të virozave apo sëmundshmërisë së stinës. Në pavion vijnë edhe pacientë për konsulta, raste që kanë dëmtime të ndryshme si kafshime nga qeni apo çarje me gozhdë (që kërkojnë bërjen e tetanozit).

**Cilat janë virozat më të shpeshta të kësaj stine?**

Në këtë moment, me ndryshimin e klimës e ftohjen e kohës, kemi një lëvizje të virozave nga



trakti gastro-intensinal në verë, drejt traktit respirator në vjeshtë. Pra, shikojmë më së shumti probleme që dalin në pjesën e sipërme të traktit respirator ku më së shumti janë tonsilitet. Kjo bën që pacientët të vijnë dhe të kërkojnë ndihmë te mjekët e lagjes apo në QSUT. Më së shumti



shfaqin shqetësime me temperaturën e lartë, dhimbjet e fytit, apo dobësi të ndryshme trupore. Pra, kemi një përzierje të situatës gastro-intensinale me atë respiratore. Më së shumti janë infeksione që lidhen me traktin e sipërm respirator.

**Cilat janë grupmoshat më të predispozuara për t'u prekur nga virozat?**

Infeksionet shfaqen atëherë kur imuniteti i trupit bie, që do të thotë se kur një organizëm nuk arrin dot t'i bëjë ballë një infeksioni, ky i fundit do të fillojë të zhvillohet. Kjo na bën të mendojmë se kemi një numër të shtuar virozash te moshat e treta, por edhe te fëmijët. Megjithatë, kjo nuk përjashton pjesën e adultëve. Kur diskutojmë për situata problematike të viruseve deri diku të veçanta mund të prekin këdo nga të rriturit. Më të riskuar janë ata që kanë një sëmundje primare, që kanë një problematikë paraprake dhe ata që kanë imunitet të rënë.

**Çfarë masash parandaluese duhet të marrë popullata për të mos u prekur nga viruset?**

Jemi në kohën më të mirë për të marrë masat parandaluese, kështu që në vjeshtë duhet të marrim masat për stinën e dimrit. Në këtë të fundit, më problematike janë infeksionet e traktit respirator, ku më problematiku ngelet gripi. Në të gjithë botën, në muajin shtator dhe tetor duhet të kryhet vaksinimi, pra është koha kur ne duhet të përgatisim trupin tonë për të bërë të mundur ruajtjen dhe mbrojtjen nga ky lloj virusi. Dhe që të bëhet kjo, duhet të përdoret vaksinimi.

**Cilat janë llojet e vaksinave kundër gripit që mund të përdorim për parandalim?**

Fatmirësisht tashmë janë në dispozicion vaksina të ndryshme për gripin dhe veçanërisht kur flasim për vaksinat katër valente. Kjo do të thotë se nëse deri vitin e kaluar kemi pasur vaksina të cilat mbronin nga gripi H1N1, H3N2 dhe një grip i tipit B; këtë vit është rritur mundësia për të marrë vaksinën katër valente që kemi dy të gripit A dhe dy të gripit B. Në këtë lloj mënyre, ne bëjmë një mbrojtje akoma më efektive nga gripi që do të vijë. Vaksina e gripit mund të gjendet në farmaci.

**Cilat janë pasojat që mund të shkaktojë gripi?**

Problematikat nga gripi mund të jenë shumë të mëdha. Sipas statistikave, ka rreth 170 mijë vdekje nga gripi vetëm në Europë, 22 milionë raste të rënda dhe rreth 3.5 milionë hospitalizime. Gripi nuk të fal kur flasim për persona që kanë një imunitet të rënë dhe kjo është arsyeja kryesore që duhet t'i japim rëndësinë e duhur vaksinimit. Është koha e duhur për nisjen e fushatës së ndërgjegjësimit për të bërë të mundur parandalimin e këtyre pasojave që mund të jenë edhe fatale.



## Mjeku popullor: Forconi imunitetin dhe kockat duke konsumuar këtë bimë

# Merja: Efektet e mrekullueshme të hithrës në organizëm

## "Receta mikse për një zemër të shëndetshme"

Voltiza Duro

Hithrat janë një bimë medicinale që përdoren në gatime të ndryshme si byreku, por duket theksuar fakti që janë shumë të shëndetshme, pasi përmbajnë mbi 50 përbërës kimike. Hithrat kanë shumë efekte pozitive në organizmin e njeriut e ndihmojnë në stimulimin e sistemit limfatik dhe prandaj përmirësojnë imunitetin. Këshillohen të përdoren të njoma ose të thata nga individët që janë anemikë dhe të dobët, apo që preken shpesh nga gripi. Mund të përdoren në gjellë dhe të gatuhen njësoj si spinaqi, ose në byrek, duke u përzier edhe me spinaq. Kur ziejnë, hithrat e humbasin djegien që shkaktojnë kur janë të njoma, kështu që nuk ka problem në përdorimin në gatim. Kjo bimë gjithashtu ndihmon në uljen e tensionit, zgjerimin e venave dhe arterieve dhe hollon gjakun. Hithra ka një rol të rëndësishëm në ruajtjen e një zemre të shëndetshme e nëse përdoret rregullisht, parandalon sëmundjet e zemrës. Hithrat ndihmojnë tretjen dhe largojnë parazitët në zorrë e gjithashtu parandalojnë simptomat e menopauzës dhe zbutin dhimbjet e menstruacioneve. Vlen të theksohet se përmbajnë shumë minerale, prandaj këshillohet të përdoren nga individët mbi 45 vjeç, pasi janë shumë të ushqyeshme për kockat, por ndihmojnë edhe në parandalimin e kancerit të prostatës. Nëse jeni duke përdorur hollues gjaku apo nëse keni tension të ulët, mund t'i përdorni me sasi të vogla hithrat. Nëse keni tensionin e lartë, keni yndyrna në gjak apo variçe këshillohen të përdoren rregullisht në verë kur mund t'i gjeni të njoma dhe gjatë dimrit 1 deri në 3 muaj si çaj, në muajt e ftohtë për ushqimin e kockave dhe largimin e reumatizmit. Hithrat ndihmojnë edhe në uljen e sheqerit në gjak e janë ushqyes shumë i mirë i kockave, pasi përmbajnë shumë minerale dhe vitamina dhe ushqejnë kockën. Këshillohen të përdoren për të luftuar osteoporozen dhe reumatizmën. Hithrat ndihmojnë në largimin e dhimbjes së kyçeve dhe kockave. Nëse keni dhimbje të forta të gjunjëve mund të shtypni hithrat, t'i përzieni me kripë të zezë dhe të mbështillni gjurin gjatë gjithë natës. Mund ta përsëritni për 3-4 net me radhë dhe dhimbjet e kyçeve do të ndalojnë. Lëngu i hithrave përmban gjithë këto vitamina dhe minerale dhe shkon deri në kocka.

### Përbërësit e hithrave

Hithrat e njoma dhe të thata kanë përbërës të ndryshëm, por gjatë tharjes, bima i humb disa nga përbërësit aktivë. Në hithrat e njoma ndodhen flavonoide me shumicë, të cilat janë në sasi më të vogla në hithrat e thatë. Flavonoidet janë antioksidantë që ndodhen tek shumë bimë dhe fruta dhe ndihmojnë në pastrimin e organizmit nga toksinat, ulin rrezikun për shumë sëmundje si kanceri etj. Gjenden beta karotenoide si beta-karoten, të cilat ndihmojnë në forcimin e sistemit imunitar dhe në përmirësimin e shikimit. Hithrat e njoma përmbajnë vitamina si: A, C, D, E, F, K, P, and B-komplekse gjithashtu thiamin, riboflavin, niacin, and vitamin B-6, të gjitha janë në nivele të larta antioksidantësh. Përmbajnë rreth 16 aminoacide, të cilat ndihmojnë në rigjenerimin e qelizave në organizëm. Gjethet e thara janë analizuar për përmbajtjen ushqyese, janë të pasura me vitaminë E, vitamina B2, hekur, zink, kalcium, etj. Hithrat e thara e humbasin vitaminën C dhe beta-karotenin, por përmbajnë të 16 aminoacidet dhe përbërësit e tjerë.



Mjeku popullor Ylli Merja

> "Hithrat ndihmojnë tretjen dhe largojnë parazitët në zorrë e gjithashtu parandalojnë simptomat e menopauzës dhe zbutin dhimbjet e menstruacioneve.

### Mikser me hithra

Kjo përzierje mund të përdoret përpara ushtrimeve fizike, apo përpara se të shkoni në palestër. Ky lëng frutash i shëndetshëm për zemrën dhe trurin ka këta përbërës: 2 lugë kos, 10 gramë gjethe hithra të njoma, 10 gramë spinaq, 1 kivi, 1 mollë, 20 gramë lakër të kuqe, pak akull dhe 1 lugë me fara chia. Futen të gjitha në mikser dhe përzihen derisa të bëhet masë e njëtrajtshme. Në fund shtohen 3-4 thelpinj arre dhe përzihen përsëri në mikser.





# 11 këshilla të thjeshta për parandalimin e ankthit

Të gjithë përjetojmë ankth në momente të caktuara të jetës, sidomos në çaste kritike, si rrugës për një intervistë pune, përpara provimeve apo kur do takojmë një person të ri. Ankthi është pjesë e jetës sonë dhe funksioni i tij mund të krahasohet me atë të tensionit të gjakut. Ne na duhet një nivel i caktuar i tij që të jetojmë, por nëse ky nivel ngrihet shumë, atëherë mund të na dëmtojë. Pra, një nivel i caktuar ankthi është i dobishëm, sepse na shtyn që të veprojmë, të marrim vendime dhe të zgjidhim problemet tona. Por, në rastin kur ankthi bëhet pjesë e pandashme e jetës sonë, atëherë ai kthehet vetë në një problem. Njerëzit që vuajnë nga ankthi kronik shpenzojnë një pjesë të mirë të ditës duke u shqetësuar dhe u frikësuar për çfarë mund të ndodhë në të ardhmen. Ankthi kronik është paralizues, na detyron të harxhojmë shumë energji emocionale dhe ndërhyn në aktivitetet tona të përditshme, duke na bërë të ndihemi të lodhur fizikisht dhe të ngarkuar psikologjikisht. Lajmi i mirë për të gjithë ata që bashkëjetojnë me ankthin është që çdokush mund të mësojë të menaxhojë ankthin nëpërmjet teknikave të ndryshme, disa prej të cilave do të trajtohen në vijim. Këto teknika mund të përdoren nga kushdo për të mbajtur në kontroll simptomat e ankthit dhe për t'u ndjerë më mirë. Duhet theksuar ama se në rastet e nivelit të lartë të ankthit, ndihma e psikologut apo psikoterapistit është e nevojshme. Ankthi është një gjendje irrituese dhe e dhimbshme. Për këtë arsye nuk është e çuditshme që shumë njerëz janë në kërkim për trajtimet efektive për të luftuar ankthin. Intensiteti, kohëzgjatja apo shpeshtësia e ndodhjes së ankthit është në proporcion me marrëdhënien me ngjarjet frikshme. Këto njerëz praktikisht e kanë të pamundur të harrojnë shqetësimet dhe u kushtojnë të gjithë vëmendjen e tyre. Më poshtë po japim disa këshilla të thjeshta për të parandaluar ankthin dhe për të bërë një jetë të qetë plot harmoni.

**Planifikoni kohën tuaj**

Në përgjithësi, njerëzit janë shumë të shqetësuar, të paorganizuar, gjithmonë kanë gjëra për të bërë dhe kjo shkakton ankthin e tyre.

**Përqendrimi është pika e dobët e njerëzve të shqetësuar**

Ju nuk mund të qëndroni të përqendruar gjatë në një detyrë, sepse ankthi ju bën të mendoni se çfarë duhet të bëni në të ardhmen.

**Mos i lini gjërat e papërfunduara**

Nëse gjithmonë ju mbetet diçka për të bërë, do të jetë një faktor ankthi.

Një orë në ditë rezervoni për të bërë atë që ju pëlqen

Qetësia është një tjetër faktor i rëndësishëm për të eliminuar ankthin.

**Fokusohuni në të tashmen**

Ankthi ju largon nga realiteti, duke menduar për të kaluarën apo të ardhmen edhe ju pengon të shijoni të tashmen.

**Merrni frymë thellë**

Një nga mënyrat më efektive për të eliminuar ankthin: shpenzoni të paktën 10 minuta në mëngjes dhe 10 minuta në mbrëmje për të marrë frymë thellë dhe relaksohuni.

**Bëni aktivitet fizik**

Ankthi gjeneron tension në trup dhe ushtrimet janë mënyra më e mirë për ta eliminuar atë pozitivisht. Me pak ushtrime ju mund të merrni shumë përfitime.

**Flini mjaftueshëm**

Gjumi na lejon të shërohemi nga shenjat e lodhjes dhe madje na ndihmon për të gjetur zgjidhje të reja për problemet.

**Kufizoni monologun mendor**

Një masë efektive për të kontrolluar ankthin është devijimi i monologut mendor.

**Pranoni se jeni të shqetësuar**

Hapi i parë për t'u shëruar nga ndonjë problem emocional apo psikologjik është që të pranoni se vuani.

**Ekuilibroni dietën ushqimore**

A e dini se ka disa ushqime që shkaktojnë ankth dhe të tjera që të zbusin shenjat? Sigurohuni që të konsumoni çdo ditë sasi të mjaftueshme të vitaminave B dhe acide yndyrore të tilla si omega 3, si dhe duhet të reduktoni konsumimin e pijeve energjetike dhe kafen.

**Provoni ilaçet bimore**

Në vend të përdorimit të ilaçeve, ju mund të provoni disa kura bimore.



# Këshilla

## Si të pastroni mëlçinë me vajin e ullirit

Sëmundjet që prekin mëlçinë po kthehen në një shqetësim madhor në mbarë globin. Miliona njerëz vuajnë nga këto sëmundje, disa prej të cilave vdekjeprurëse, të cilat në shumë raste mund të shmangen falë ndryshimeve në stilin e jetesës. Mëlçia, si çdo organ tjetër, është një shënjestër e lehtë e toksinave dhe kimikateve që na rrethojnë çdo ditë. Natyrshëm, ky organ ka nevojë për ndihmë që të pastrohet prej toksinave dhe organizmave të rrezikshëm, prania e të cilëve vë në rrezik edhe trurin. Një nga përbërësit kryesorë të të gjitha kurave për pastrimin e mëlçisë është vaji i ullirit. Mëlçia luan një rol qendror në detoksifikimin e trupit dhe kryen një sërë detyrash dhe funksionesh, duke nisur që nga prodhimi i proteinave, kolesterolit, ruajtjes së vitaminave, mineraleve dhe karbohidrateve. Ajo shpërbën toksinat që shoqërojnë alkoolin, ilaçet apo nënproduktet natyrale të metabolizmit. Mbajtja në formë e mëlçisë është tejet e rëndësishme për shëndetin. Vaji i ullirit ofron shumë vlera të shëndetshme, një prej tyre është pastrimi i mëlçisë. Sipas studimeve, pirja e vajit të ullirit e ndihmon mëlçinë të përshpejtojë përpunimin e çdo substance. Ai ndihmon edhe në largimin e substancave të dëmshme të ngecura në organ sa më shpejt. Vaji natyral i ullirit është kura më e mirë për mëlçinë, por në përzgjedhjen e tij duhet të tregoheni të kujdesshëm. Është e rëndësishme që të përzgjidhni vajin e nxjerrë nga ullinj të përpunuar sa më pak dhe të nënshtruar një presimi të ftohtë. Vaji ekstra i virgjër i ullirit është ai që nuk është nxjerrë nga një presim i nxehtë i ullinjve apo që nuk përmban kimikate. Freskia është një aspekt i rëndësishëm në përzgjedhjen e vajit të ullirit. Vaji i ullirit nuk duhet të qëndrojë i papërdorur për shumë kohë. Vajrat që nuk konsumohen brenda dy viteve nga data e prodhimit nuk janë të shëndetshëm.



Kura treditore e pastrimit të mëlçisë

Kura e mëposhtme zgjat tri ditë dhe duhet bërë në mbrëmje përpara se të bini për të fjetur. Këshillohet që të përzieni në një mikser gjysmë gote me vaj ulliri dhe gjysmë gote me lëng të freskët limoni. Pijeni lëngun menjëherë dhe shtrihuni në shtrat, qëndroni shtrirë me gjunjët të mbështetur mbi kraharor për 30 minuta. Kjo kurë duhet shoqëruar me konsumin e mollëve dhe lëngjeve të saj, të cilët gjithashtu kanë efekt pastrues.





## Kombinimi i veçantë i frutave, avokados e spinaqit

**Ky kombinim lëngjesh natyrale të gjelbra është një ushqim i shëndetshëm dhe plot me vlera ushqyese për organizmin. Në fakt, është një bashkim lëngjesh mirëbërëse me të cilat nuk është e lehtë të ngopesh. Shumë konsumatorë të moshave të ndryshme i duan dhe i vlerësojnë kombinimet e bëra vetë të lëngjeve natyrale dhe vazhdimisht përdorin të paktën një për çdo vakt. Perime, fruta dhe barishte, të gjitha bashkohen në përzierje pa as më të voglin shqetësim. Duhet ta dini se ajo që do të përfitoni është vërtet tejet e shijshme. Me të vërtetë, është një pije e madhe për t'u përgatitur dhe për ta ndarë me miqtë tuaj. Shija e kombinimit është kaq e butë, e ëmbël dhe e freskët. Ju pini një bashkim vlerash si ky lëng dhe do të ndjeni vitaminat që rrezatojnë përmes**



**trupit tuaj. Kjo është një zgjidhje e mrekullueshme sidomos gjatë ditëve të nxehta, pasi ofrohen edhe kripëra minerale aq të vlefshme për organizmin.**
**Përbërësit: një gotë 250 ml me ujë të ftohtë, 1 lugë çaji me vanilje pluhur (opsionale), 250 gramë spinaq të freskët, 1 kërcell selino, i copëtuar, 1 kivi, të prerë në feta, 1 mollë e gjelbër, e prerë në feta, 1 dardhë e gjelbër, e prerë, gjysmë kastraveci, gjysmë avokado, 8-10 kuba akulli. Në një mikser me shpejtësi të lartë vendosni të gjithë përbërësit në rendin e përshkruar më lart. Sigurohuni që spinaqi të vendoset i pari nga të gjithë përbërësit e tjerë për të siguruar që çdo gjë të përzihet pa copat e gjetheve të spinaqit. Përziejini me shpejtësi të lartë për rreth 45-60 sekonda dhe shijoni lëngun në një gotë të gjatë. Ju mund ta ndani në 2 gota ose të ruani gjysmën për më vonë. Kur të jeni gati për të pirë lëngun e mbetur (brenda 24 orëve), hidhni në mikser 5-6 kube akulli të tjerë dhe ripërziejeni.**

FESTIVALI I FILMIT

# Oleg Sentsov

# Kurov: Nëse burgosin një artist, askush nuk është i mbrojtur




Fatmira Nikolli

*Historia e regjisorit ukrainas, që vuan burgun rus për terrorizëm*

*Kryeministri Rama, në filmin për artistin që doli kundër Putinit*

*Historia e një artisti kundër pushtetit, e një artisti që ngrihet kundër politikave të presidentit rus, Vladimir Putin dhe vihet përballë gjyqit dhe vuan dënimin në burg. "The state of Russia" ka qenë filmi që mbylli Festivalin Ndërkombëtar të Filmit për të Drejtat e Njeriut në Tiranë. Në ceremoninë mbyllëse, i pranishëm ishte edhe kryeministri i vendit Edi Rama. Mbetet domethënëse përballja e kryeministrit me një film të tillë, kur ai është i vendosur se kompleksi i Teatrit Kombëtar duhet shembur dhe kur artistë e regjisorë janë të vendosur ta mbrojnë me trupat e tyre.*

Por kur është regjisori nga Krimeja?

Oleg Sentsov është regjisor dhe producent filmash në Ukrainë. Ai u vu në qendër të vëmendjes pas aneksimit të Krimesë nga rusët në vitin 2014, pasi më herët ai kishte dalë kundër 'bashkimit' ideologjik të Ukrainës me Rusinë gjatë protestave të përgjakshme në "Meidan". Sentsov ishte më pas kundërshtar aktiv i pushtimit të Krimesë nga Rusia derisa në maj të 2014 u arrestua nga rusët me akuzën e terrorizmit. Sentsov u kthye në simbolin e qëndresës së Krimesë dhe qëndresa artistike për rastin e regjisorit kulmoi me filmin-dokumentar "Gjyqi" të një prej miqve të tij, Askold Kurov.

Në intervistën e tij për "Gazetën Shqiptare", Kurov flet për mikun e tij e simbolin e rezistencës, Oleg Sentsov.

"Unë nuk kam parë rezultat të kësaj fushate, por nuk mund të ndalojmë. Duhet të vazhdojmë me këtë presion dhe duhet të shpikim diçka të re që t'i kujtojmë botës, politikës dhe medias se autoritetet ruse e kanë në burg. Këto raste janë të lehta për t'u harruar sepse ka lajme përditë", thotë regjisori i filmit "The State of Rusia". Për Kurov, Oleg është simbol i situatës. "Edhe në burg, hyri në grevë urie dhe kërkoi që të lirohen të burgosurit politikë ukrainas. Dhe nuk e përfshin veten në këtë listë. Ndaj për shumë njerëz, të luftojnë për Oleg është si të luftosh për gjithë të burgosurit politikë".

Kurov jeton në Moskë, por pas arrestimit të mikut të tij ka krijuar shumë miq në Ukrainë. "Kam takuar miqtë e Olegut, familjen e kolegët. Nuk kam dashur të bëj filma për çështje politike, por situata ndryshoi shumë në rusi këto vite. Nëse kjo i ndodh Olegut, do të thotë se asnjë s'është i mbrojtur, as nëse je i njohur, nuk je i mbrojtur. Nëse ia bëjnë këtë dikujt që


Regjisori Oleg Sentsov, i dënuar për terrorizëm

është pak a shumë i famshëm, mund t'ia bëjnë kujtdo. Nëse nuk u intereson asnjë provë, atëherë kështu mund të trajtojnë këdo", thotë Kurov.

**- Si e keni njohur ju Sentsov?**

E kam takuar Sentsov tri vite para se të ndodhnin të gjitha kjo. Ne të dy, sapo kishim filluar të merreshim me filma dhe unë bëja dokumentarë e ai filma. Nuk kishim diskutuar çështje politike, vetëm për filma flisnim.

**- Çfarë filmash bënte?**

Filmi i tij i parë bazohet në historinë e tij të vërtetë, sepse ai para se të merrej me film, luante dhe ishte kampion sporti, dhe ishte pronari i një prej klubeve më të mëdha në Ukrainë. Kur vendosi të bënte filmin e parë, ai shiti klubin dhe makinën. Filmi i tij është autobiografi për një djalë të ri, që përpiqet të gjejë vendin e tij në jetë. Nuk shkoi në shkolla filmi, ishte autodidakt. Pasi fillova me dokumentarët, lexova skenarët e tjerë që ai kishte për filma. Ishin interesantë. Ai është një prej regjisorëve më të mirë e më të talentuar të filmit në Ukrainë të paktën.

**- Kur filmi yt për të u shfaq, si u prit?**

Në Rusi është e vështirë, sepse edhe mediat e pavarura që mbështetën vetë Olegun që në fillim dhe filmin tonë për gjyqin që iu bë. Dokumentari e pati premierën vjet në Berlinale. Për Rusinë ishte gjë e madhe dhe ishte sukses. Media kryesore megjithatë, thjesht e injoroi këtë dhe nuk foli kurrë për filmin.

Mediat e pavarura e mbuluan ngjarjen.

**- E ka parë Olegu filmin?**

Nuk e ka pasur mundësinë, sepse është në një burg të sigurisë së lartë dhe ka TV, por mund të shohë vetëm kanalet shtetërore.

**- E ke takuar?**

Po, e kam takuar në qershor, pasi shkoi në grevë urie -




**Të lejuan ta takoje?**

Po, por shkova të bëja një video të avokatit të tij që shkonte në burg te Olegu dhe papritur u lejova të takoja Oleg edhe unë. Patëm një takim 45-minutësh.

**- E xhirove?**

Jo. Është e pamundur. Sepse nuk lejohet të kesh asnjë aparat me vete, as kartë SIM. Folëm për shumë gjëra. Donte të dinte çfarë po ndodhte në botë dhe për fushatën në mbrojtje të tij në kinema, festivale.

**- Çfarë mendon se do ndodhë me të pasi njerëzit kanë parë filmin. E ka ndihmuar të ndryshojë diçka?**

Ky dokumentar ndihmon shumë për fushatën, sepse është shfaqur në të gjithë botën dhe i bashkohen fushatës. Filmi ndihmon për zgjerimin e fushatës, por nuk ndryshon gjë për situatën e vetë atij, sepse autoritetet ruse i injorojnë të gjitha protestat. Ka pasur fushata e protesta të mbështetura nga Akademia Europiane e Filmit kur ai u arrestua para 4 vitesh e regjisorë të famshëm dhe shkrimtarë të njohur i janë bashkuar fushatës si edhe politikanë si Emanuel Macron. Janë përpjekur ta diskutojnë me Putin, por s'ka ndryshuar gjë. Varet vetëm nga Putin sepse është çështje politike që varet nga vendime politike.

- Një film për një njeri si Oleg nuk është e thjeshtë. Pse e bëre?

Si mik i Oleg, shkova në gjyq vetëm për ta parë atë. Që të më shihte se e mbështes. Nuk e dija çfarë do të bënte gjykata ruse, por kur e sheh se sa i pafuqishëm je, kur sheh argumente absurde dhe që s'kanë asnjë provë, mendova se s'mund të bëja asgjë. E vetmja gjë që mund të bëja ishte një dokumentar ku të tregoja historinë e tij.

# Hervin Çuli: Festivali mbarëkombëtar, mbledhim teatrin shqip në Tiranë

*"80 milionë lekë të vjetra për 14 trupa, dy shfaqje në ditë"*

Fatmira Nikolli

Imazhi bazë i Festivalit Mbarëkombëtar të Teatrit që u hap mbrëmë në "arTurbina" është një foto nga "Topazi", ku regjisori Andon Pano me Olga Shyraja marrin pjesë në shfaqjen e parë të Teatrit Kombëtar. Nis me këtë shpjegim, konferenca për mediat e Hervin Çulit, drejtorit të Teatrit Kombëtar në ekzil, që prej 1 muaji po përqendron punën në ambientet e skenës së re, te "arTurbina". Një set kartolinash me imazhe të shfaqjeve të teatrit të viteve 1950, shënjuese librash, e bluza me nistoret e Festivalit Mbarëkombëtar të Teatrit, janë shpërndarë në tavolinën e tij. Për Çulin është një moment historik. FMT do të zhvillohet në datat 23-30 shtator.

"Përveç çeljes së Festivalit Mbarëkombëtar të Teatrit, një ngjarje që kthehet pas 20 e ca vitesh, për herë të parë në skenën e 'arTurbinës' kemi një premierë teatri, veç koncerteve që janë mbajtur këtu. 'Tag' është shfaqje historike, sepse ajo është e parë që luhet në skenën e madhe të 'arTurbinës'. Festivali është një eveniment për të cilin unë kam luftuar shumë dhe e bëmë realitet. Marrin pjesë 14 trupa teatrore nga gjitha trevat shqipfolëse, Shqipëria, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi me një volum të jashtëzakonshëm, dy shfaqje në ditë. Në orën 18:00 në sallën e Universitetit të Arteve dhe në 21:00 në 'arTurbinë'. Ka mbështetjen e plotë të Ministrisë së Kulturës me rastin e vitit të Skënderbeut dhe kemi një ndihmë nga Bashkia e Tiranës. Është festë e madhe për teatrin shqiptar", thotë Çuli.

Nuk ka pasur përzgjedhje të pjesëve që vijnë në Tiranë. "Vendosëm t'u drejtohemi teatrove publikë dhe ata të përzgjedhin veprën që mendojnë se është më e denja për të marrë pjesë në FMT. Nëse e bëjmë FMT-në vitin tjetër, do e kemi përzgjedhës sepse ka shumë shfaqje nga skena e pavarur që duhet të jenë pjesë e një festivali të madh".

I pyetur për ndarjen e fondit, ai tha se teatrot i sjellin vetë rekuizitat, nuk ka buxhet për ta. "Ka një juri që përbëhet nga presidenti i festivalit e kryetari i jurisë, Ndriçim Xhepa, e në juri janë edhe Luli Bitri, Shkumbin Istrefi, Qëndrim Rijani dhe Josif Papagjoni". I pyetur për spotin promovues, ku shihen edhe Reshat Arbana e Ndriçim Xhepa, Çuli bëri me dije se, "spoti ka qenë ide e imja që figurat më të njohura të artit shqiptar të ishin ato që i bënin thirrje publikut shqiptar që të ishin pjesë e festivalit dhe 'arTurbinës', që është një sallë e re që duhet ta promovojmë që të jetë e frekuentuar nga publiku".

Për festivalin në tërësi, në dispozicion kanë qenë 80 milionë lekë të vjetra nga ministria, 7 milionë nga një bankë dhe në zërat teknikë është ofruar Bashkia e Tiranës. "Ajo që krijon vështirësi në një festival është akomodimi (hoteleria) dhe ushqimi. Nuk ka ndarje për secilën shfaqje, është një buxhet në total, që bëhet për të gjitha shfaqjet me numrin përkatës të trupave, me njerëzit, duke arritur që t'i akomodojmë sa më mirë. Pjesa tjetër, do kemi çmime dhe kjo është e rëndësishme, se kemi shumë çmime. Është natyrë garuese e kemi 9 çmime: Shfaqja më e mirë, regjia më e mirë, aktori dhe aktorja kryesore më e mirë, aktori dhe aktori i rolit të dytë më të mirë, çmimin e skenografisë, kostumografisë që është një çmim që pothuajse është eliminuar, por për ne është shumë i rëndësishëm", drejtori i TK-së në ekzil, Hervin Çuli. Ai tha se kanë nisur përgatitjet para 6 muajsh, ndërsa muajin e fundit përqendrimi ka qenë në 'arTurbinë', sepse "dihet aktiviteti i TK-së do vazhdojë te skena e re".

**"TAG"**

Komedia e Bashkim Hoxhës pati provën gjenerale të shtunën, me arkitektin e 'arTurbinës', Olsi Eftimi që monitoronte nga cepat e sallës, punën e tij me institutin e kthyer në skenë arti.

Me regji të Andia Xhungës, e me shumë elemente të "Zonjës nga qyteti" jo vetëm në personazhe (si risjellja ndryshe e Koçit apo e postierit) që përforcoheshin me hyrjen në skenën e lokalit të fshatit të Melit (Rajmonda Bulku) mes batutave e naivitetit të fshatit dhe batutave politike të Ramës e Bashës, shfaqja nuk linte vend për imagjinatë. Aktualiteti politik e social vinin pa komplikime dhe pa mesazhe të koduara. Përqeshja e deputetit nga Artan Imami përmes lidhjeve me 'skype' ripërsëriste batutat e politikanëve duke baltosur edhe në skenë imazhin që lënë jashtë saj. Megjithëkëtë, komedia nuk ia del të ketë epërsi të dukshme dhe të sjellë parasysh spektaklet televizive të fundjavës që përqeshin ato që ndodhin gjatë javës. Olta Daku ruan si gjithnjë pozicionin e imazhin e saj në skenë, sikundër Mehdi Malka. Bitraku qëndron mirë brenda kostumit të veterinerit, sikundër Adelina Muça në atë të vajzës së fshatit. Cerga si shqiptar i kthyer nga Italia e përcjell mirë emigrantin që flet sa italisht, aq shqip, ndërsa personazhi i Deçkës dhe Ferrës ruajnë balancat në skenë. Skenografia e Shkodranit bën diferencën dhe në po atë nivel është edhe kostumografia e Kokonës.

Vepra ka në role aktorë të Teatrit Kombëtar, por edhe jashtë tij. Për të sjellë këtë vepër teatrore shqiptare, regjisorja Andia Xhunga ka zgjedhur aktorë si Olta Daku, Gert Ferra, Indrit Çobani, Adelina Muça, Naun Shundi, Mehdi Malka, Ardian Cerga, Erjona Kakeli, Besmir Bitraku, Artan Imami, Genti Deçka. Skenografia i është besuar skenografit Genc Shkodranit, ndërsa atmosfera e fshatit në kostume vjen nga Berina Kokona.




## VELIAJ PËR TEATRIN

Festivali u çel dje më mbrëmje me praninë e emrave të skenës e politikës. Ndriçim Xhepa, kryetar i jurisë tha se, "është vlerë që rifillon ky festival i teatrove, që një herë në dy duhet bërë që krijimtaria e trupave të rretheve të kenë mundësi që të zgjedhin gjënë më cilësore të tyre. Sugjeroj që mos të mbetet vetëm në Festivalin e Tiranës, pas dy viteve të bëhet në Tiranë, në Shkup. Ndoshta nga lëvizja e skenës dhe nga ana ekonomike mund të lehtësoheshin bërja e këtyre". Kryetari i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj u shpreh se është i lumtur për festivalin bashkë. "Sa herë bëjmë gjëra të tilla hasim faktin se njerëzit thonë që ne nuk kemi bukë të hamë. Por unë bëj pyetjen, pse nuk kanë nevojë njerëzit për teatër, film etj.? Besoj se teatri i ri është shembull, më pak preokupim për llaç e tulla, por me ato pak para që ne kemi të financojmë teatro si ky që ne kemi sot", tha ai. Ministrja e Kulturës, Mirela Kumbaro tha në fjalën e saj se, "bashkë me miqtë e mi konceptuam këtë festival mbarëkombëtar, pasi morëm shtysë për vitin mbarëkombëtar të Skënderbeut".

## "EUROPA NOSTRA" NUK U LEJUA NË TEATËR, ÇULI: GËNJESHTËR TOTALE

A e keni ndaluar ju ekipin e "Europa Nostra"-s të vizitojë nga brenda Teatrin Kombëtar? Kjo ishte pyetja e fundit drejtuar drejtori i TK-së, Hervin Çuli dje në konferencën për mediat. "GSH" kërkoi përgjigje për të kuptuar më shumë se çfarë ndodhi me ekipin që pasi takoi ministren Kumbaro, nuk ia doli të hyjë në një godinë nën varësi të saj. Përgjigja e Çulit qe e gjatë. "Është gënjeshtër totale, sepse e para, mua nuk më kanë sjellë ndonjë shkresë zyrtare? Kushdo qofshin, mund të vijë edhe Robert De Niro në Shqipëri dhe të dojë të vizitojë Teatrin Kombëtar. Dini ju gjë që më kanë sjellë ndonjë shkresë zyrtare? Të nxjerrin shkresën zyrtare", tha ai. Çuli shtoi se "Po, më është bërë një telefon, rreth drekës dhe më është thënë a vini ju ta hapni këtë derën e Teatrit Kombëtar se janë disa që duan të futen brenda ta shohin? Unë nuk besoj që shteti funksionon në këtë mënyrë, që unë shkoj atje, hap derën e teatrit dhe fus disa njerëz, kushdo qofshin ata". Duke mos dashur që lajmi i festivalit të përzihej (a sfumohej) me këtë të "Europa Nostra"-s, Çuli theksoi se, "nuk kemi kërkesë zyrtare, ne jemi të hapur. Mund ta shohë Teatrin Kombëtar kushdo. Edhe ju. Na sillni një kërkesë zyrtare, ne ju vëmë një njeri në dispozicion. Nuk mund të futet kushdo brenda pa pasur një monitorim. Ne nuk po mbajmë ndonjë sekret aty".

Në vijim të përgjigjes, Hervin Çuli tha se Teatri Kombëtar për momentin është jofunksional. "Sipas konkluzioneve që ka sjellë Instituti i Ndërtimit dhe i Monumenteve është një teatër që për momentin nuk ka parametrat e duhur për të qenë funksional e normal për publikun. Është një teatër për momentin i kyçur derisa t'i jepet një rrugëzgjidhje. Teatrit nuk i ka lëvizur asgjë, nesër a pasnesër do ketë një rrugë e një përgjigje për të, do ketë Teatër të ri Kombëtar, do ketë rikonstruksion, për momentin është Teatër ku marrim rekuizita a mjetet që na duhen, por i kyçur për aktivitet artistik".

Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit po proteston prej 100 ditësh çdo natë në mbrojtje të kompleksit të dy Teatrove Kombëtare, teksa një ligj që aprovon shembjen ka kaluar për herë të dytë në parlament. Pas vizitës së Doris Pack ditën e shtunë, kompleksin e dy Teatrove Kombëtare e vizitoi një grup nga "Europa Nostra" - organizata më e madhe evropiane që merret me trashëgiminë kulturore dhe natyrore në kontinent. Grupin e kryesonte vetë zv.presidenti i organizatës. **fa.ni.**

Intervista e Ditës

# Desir: Sulmet ndaj gazetarëve sjellin klimë kërcënimi e vetëcensure

Nga Adelheid Feilcke

*(vijon nga faqja 1)*




...Desir, i ngarkuari i OSBE për lirinë e medias.

Mediat në vendet e Ballkanit Perëndimor ndodhen në presion të shumanshëm, lidhur me lirinë e shtypit dhe mendimit ka ende shumë gjëra që nuk shkojnë si duhet. Cilat janë shkaqet sipas jush?

Problemi më i madh i medias në Ballkanin Perëndimor është (rrezikimi) i sigurisë së gazetarëve. Kemi parë shumë sulme dhe kërcënime në të shkuarën. Ende autorët mund t'i shpëtojnë dënimit ose nuk marrin dënimin e merituar. Për shembull, në Malin e Zi u qëllua gazetarja Olivera Lakiq dhe autorët nuk janë kapur ende. Kjo gjë krijon një klimë kërcënimi dhe madje edhe vetëcensure. Por është edhe një çështje e respektit nga ana e politikës. Shtypi duhet të respektohet, edhe nëse është kritik. Gazetaria nga natyra e saj është kritike. Ajo është një aktore e rëndësishme e demokracisë, sepse u kërkon llogari atyre që janë në pushtet. Dhe ajo e ndihmon opinionin publik me informacione të pavarura duke lejuar kështu një debat pluralist. Prandaj, është një detyrë shumë e rëndësishme që në media të mundësohet pluralizmi dhe shumëllojshmëria e mendimit. Në shumë vende, mediat janë nën presion ekonomik dhe nën presionin e interesave politike, që i përdorin mediat për të vulosur mendimin publik, për ose kundër qeverisë. Prandaj është i rëndësishëm krijimi i mediave të pavarura, që kanë si motivim gazetarinë profesionale. Ne duam ta mbështesim gazetarinë cilësore dhe pluralitetin e mendimeve. Për këtë kemi nevojë për rregulla të ndershme, shtetin ligjor dhe respektimin natyrisht të lirisë së mendimit. Dhe natyrisht, duhet që të mos ketë përpjekje përmes reklamave të komanduara politikisht të ushtrohet ndikim tek media, që të blihen ato apo të ushtrosh presion mbi gazetat që përfaqësojnë një mendim tjetër.

Pas kësaj analize, çfarë bëni ju kundër këtyre zhvillimeve si i ngarkuar për mediat i OSBE?

Vitin e kaluar kam ndërhyrë më shumë se 40 herë tek qeveritë e vendeve të Ballkanit Perëndimor. Të gjitha këto vende janë anëtare të OSBE-së dhe kanë marrë përsipër detyrimin të respektojnë lirinë e shtypit dhe mendimit. Pra, ato më kanë dhënë një mandat si përfaqësues i lirisë së mediave të ankohem publikisht apo me rrugë diplomatike, sa herë që ka pasur kërcënime ndaj gazetarëve, moskrijimin e kushteve të punës për median apo kur ka pasur kërcënime ndaj pluralitetit të medias. Pra, ne punojmë me ta. Kam dhënë disa herë rekomandime ligjore për qeveritë për reforma të reja. Ne angazhohemi që për shembull, financimi i televizioneve e radiove publike të jetë i qëndrueshëm dhe i pavarur nga politika redaksionale. Ky është një proces i vështirë, që mendoj se do të zgjasë gjatë. Por mendoj se urgjenca për të është e madhe. Sepse këto vende janë në proces të afrimit me BE. Dhe është e qartë, që nuk ka për të pasur demokratizim, nëse nuk ka media të lira, të pavarura dhe pluraliste.

Pas një viti në post, si i shikoni zhvillimet në mediat e Ballkanit Perëndimor? Po shkon tendenca drejt përmirësimit apo përkeqësimit?

Ka dallime nga vendi në vend. Mund të them, se në Maqedoni kemi parë ndryshimet më të mëdha në vitin e kaluar. Klima e mediave është tërësisht ndryshe dhe legjislacioni për to është përmirësuar. Por ajo që shohim në të gjithë rajonin është se ka shumë kërcënime ndaj gazetarëve. Ka një boshllëk në mes të ligjeve, që në shumë raste janë të mira, dhe zbatimit të tyre, që nuk reflekton respektin e vërtetë për pluralizmin dhe pavarësinë e medias. Natyrisht, edhe presioni financiar është shumë i madh ndaj mediave, si kudo në botë. Por, situata është më e vështirë në këtë rajon, sepse tregjet janë të vogla. Mendoj se është e nevojshme të mbështetet digjitalizimi dhe se si përshtaten mediat me të. Vetëm kështu mund të garantojmë që edhe në të ardhmen të ekzistojë një peizazh mediatik pluralist e gjallërues si edhe një gazetari cilësore. Prandaj, ne mbështesim edhe mirërregullimin e mediave, ngritjen e këshillit të medias dhe respektimin e të drejtave të punës së gazetarëve, për të pasur gazetarë të fortë që janë në gjendje të lirohen nga presioni politik.

Harlem Desir është një politikan francez, sekretar shteti për çështjet europiane në Ministrinë e Jashtme të Francës dhe nga viti 2017 i ngarkuar i OSBE-së për lirinë e medias.



Opinioni i Ditës

# Këshilla praktike për punësim në shtet

Nga Sulejman Mato

*(vijon nga faqja 1)*

…për detyrë të jap disa këshilla praktike në ndihmë të të rinjve që pasi mbarojnë fakultetet, madje pajisen me diplomë masteri, të mund të gjejnë një punë në shtetin tonë të dashur. Në fakt, këshillat praktike ndryshojnë sipas gjinisë dhe moshës. Ju mund të mendoni se punësimi në shtet sot ka ndryshuar, nuk është më ai i pari, që bëhej me miq e me pagesa nën dorë… Miku nuk vdes kurrë, por unë mund t'jua vërtetoj se jo vetëm nuk ka ndryshuar asgjë, por si miku, ashtu edhe paraja që jepet nën dorë është bërë më i vështirë dhe më e sofistikuar.

Që ta sqarojmë më në detaje këtë problem të rinisë sonë pasuniversitaree të papunë, por edhe të asaj rinie që nuk ka pretendime të shumta për të punuar nëpër ministri e institucione të larta, për shkak të arsimimit të mesëm që kanë, duhet të nënvizoj se këtu ka një dallim të rëndësishëm gjinor. Nëse dikur kërkesat ishin të barabarta si për femra, ashtu edhe për meshkuj, tashmë kërkesat janë kryesisht për femra. Është e vërtetë që përzgjedhjet bëhen me aplikime Curriculum Vitae, 'online' dhe me konkurse të hapura, ashtu siç ç'është e vërtetë se Curriculum Vitae, që dërgohen 'online' nëpër ministri dhe institucione bëhen posaçërisht për të krijuar idenë që shteti funksionon sipas ligjeve të vendeve më të qytetëruara, ndërkohë që, i dashur mik ose mikeshë, …në qoftë se e merrni seriozisht këtë punën e aplikimeve me konkurse 'online' do të zhgënjeheni shumë shpejt. Ose jeni zhgënjyer dhe vazhdoni të zhgënjeheni… Në fakt, kjo që ju them unë nuk është ndonjë gjë e re dhe as e paditur nga ju dhe nga prindërit tuaj. Nga eksperienca e tyre mund të mësoni më shumë nga sa ç'përpiqem t'ju mësoj unë. Nuk ka student e studente që pas mbarimit të fakultetit përkatës dhe pas mbarimit të masterit të mos ketë pasur një përvojë të tillë të hidhur. Vendet e punëve në shtet janë kaq të vështira sa ç'është e vështirë të hyjë një luan në vrimën e miut. Dëgjojmë shpesh nëpër biseda të pëshpëritet hidhur fraza tashmë e njohura: "Po s'pate mik të fortë e para nuk futesh dot në punë shteti". Shto këtu edhe që vajzat që pretendojnë për sekretare apo në shërbim publik duhet të jenë edhe të pashme, ndërsa djemtë duhet të jenë të përkulur, të ndrojtur dhe pak natyra servile… Po as këto karakteristika nuk mjaftojnë, të dashur miq e mikesha, që vazhdoni të ëndërroni një punësim në shtet… Ju jini shumë kuadro të dë nga bankat e universiteteve, ndërsa vendet e punës janë me kërk… Në disa raste, nuk e di, por nuk pi ujë as paraja, as miku dhe as bukuria femërore. Kanë dalë ca kërkesa të tjera, të fshehta, të cilat kanë mbetur enigmatike. Një mëngjes takova një mikeshën time, deputete… Iu luta në konfidencë për të më marrë përsipër e të më gjejë një punë për vajzën e një mikut tim. I qava hallin miqësisht. I tregova që vajza në fjalë kishte mbaruar Fakultetin Ekonomik, madje kishte mbrojtur edhe masterin e që dinte katër gjuhë të huaja… Për më tepër, familja e saj me pesë persona mbahej vetëm me rrogën e të atit të saj. Ndërkohë që unë i flisja, deputetja më pa me çudi, sikur t'i flisja për ca alienë që kishin zbritur në tokë… "Të keqen motra, dëgjo mua… Mos u merr me këtë punë. Janë shumë të vështira.Do të bëhesh armik me atë që i ke premtuar. Kështu më ndodhi dhe mua që, siç e di, jam deputete dhe më dëgjohet fjala. U futa si mik për vajzën e një kushëririt tim. Nuk bëra dot gjë dhe tani më mbajnë inat, jo vetëm kushëriri, por edhe e shoqja…". "Kaq e vështirë qenka", - i thashë. "Kaq", - ma priti ajo, duke u ndarë me mua sikur ta kisha ofenduar…




Megjithatë, ju miqtë dhe mikeshat e mia që kini aplikuar diku për një vend pune, ose prisni të aplikoni, mos i humbni shpresat. Doni t'ju tregoj edhe për një rast tjetër… Një ish-student, me disa gjuhë të huaja aplikoi për një vend pune në një ministri. "Kam biseduar unë me atë të kuadrit - i tha ndërhyrësi. - Do t'ia çosh curriculumin në dorë, vetë sekretares së ministres". Kështu ndodhi, por në fakt pas një muaji mori vesh se në atë end pune ishte futur një tjetër, madje që vinte nga rrethet… Më e çuditshmja… Currikulim Vitae i saj kishte humbur… Emri i saj nuk figuronte në konkurim… Doni një rast tjetër? Madje edhe me mik, edhe me para. Le që çfarë t'ju tregoj unë raste kur ju, po të doni mund të bëni një konkurs me rastet e shumta që dini nga eksperienca juaj dhe e miqve tuaj. Madje, mund të botohej një libër guines.

Megjithatë, ju miq e mikesha që prisni të hyni në një punë shteti, pasi i kini përmbushur të gjitha kërkesat për një vend pune, mos i humbni shpresat. Më poshtë po ju rendis disa këshilla të tjera, praktike, që t'i kini parasysh… Duke ditur që vendet e punës janë vërtet me kërk dhe përzgjedhja bëhet nga vetë ministrat dhe titullarët e institucioneve, kini parasysh diçka "nëse është ministër, dijeni që kërkesat janë për femra… Në një nga ministritë që njoh unë e që kanë kaluar shumë ministra, secili nga ministrat ka futur sipas shijes së tij preferenciale një duzinë me femra. Ato e kanë joshur me pamjen dhe u kanë rritur shpresat, sa i kanë punësuar, pastaj… Kur ministrat kanë çarë ferrën, ato kanë mbetur nëpër ministri. Dua të them që dhe koketëria në disa raste hyn në punë, sidomos kur titullarët e institucionit janë meshkuj. Nuk jam fort i sigurt dhe nuk kam fakte të di nëse dhe koketëria e meshkujve në disa raste u ka hyrë në punë, në rastet kur titullarët e institucioneve janë femra.

Përsa u përket parave që duhet të jepen nën dorë, dijeni mirë dhe duhet të jeni të sigurt, se ky është një ligj i vjetër, i pashkruar. Madje edhe shuma e parave që duhet të jepet nën dorë është e saksionuar ekzaktësisht, nga specialistë të fushës, sipas vendit dhe rëndësisë së punës… Kam dëgjuar, mos ma merrni për fakt, me të dëgjuar e kam… vendet e punës variojnë nga pesëmijë euro, gjer në pesëqind mijë euro… 250 mijë euro janë për prokurorët. Por ka edhe çmime për shoferë ministrash dhe pastruese, që dëshirojnë të punojnë në shtet… Kam dëgjuar, e kam sigurisht me të dëgjuar, se çmimet e atyre që pretendojnë për t'u punësuar si sekretare shefash nuk janë në para… Preferohen misse ose modeliste. Pranohen edhe nga ato që kanë marrë pjesë në konkurse bukurie… Për të gjitha profesionet e tjera, kërkesa bëhet me euro, pasi paraja shqiptare nuk ka stabilitet. Mund që dikujt kjo gjë t'i duket çudi? Atëherë le të bëjë një sondash në "Facebook" dhe do të dalin qindra dëshmitarë që do t'i tregojnë për tregun e zi të punësimit në shtetin shqiptar. Mos harroni që kush punon në punë shteti, sidomos ata ose ato me profesion ekonomiste që kanë të bëjnë me tendera… duhet të jenë të kuptueshëm dhe të heshtur. Nëse kërkohet nga shefi i tenderit firma e tyre për të plotësuar komisionin e tenderave të paracaktuar dhe të paravlerësuar, ata duhet ta hedhin pa hezitim. Të tjerat i di shefi… Nëse nuk e plotësojnë këtë kusht, shumë shpejt do ta gjejnë veten jashtë dyerve të institucionit. Ka edhe persona që e bëjnë këtë punë, siç ka persona që kundërshtojnë përkohësisht… Me një fjalë, shteti kërkon të punësojë persona të devotshëm, kokulët e pa fjalë edhe kur shohin që shkelen ligjet e shtetit…

Ka edhe një kërkesë tjetër jo më pak e rëndësishme: bindja politike. E lashë për në fund këtë kërkesë themelore, pasi nuk do shumë mend për t'u kuptuar se, kur janë socialistët në pushtet, pushteti u takon socialistëve… Vetëm ata e ndjejnë veten zot të shtetit. Vetëm ata kanë gojë të ankohen për një punë në institucione, pasi vetëm ata gëzojnë privilegjet e pushtetit. Kjo gjë dihet. Në shtet duhet të punësohen vetëm ata që quhen "tanët". E pra, e shihni se sa kërkesa dhe labirinte ka për të gjetur një vend pune? Ndaj, ju që nuk keni as miq, as para, madje jeni edhe me bindje të djathta, mos shpresoni për një vend pune, o të pashpresë. Aplikoni për punësim në një shtet tjetër dhe mbathjani nga sytë këmbët, pasi ky pushtet nuk është juaji. Le që ç'tju them dhe unë, gjëra që i dini dhe vetë ju, ndryshe nuk ka se si vitin që shkoi të aplikonin për lotari amerikane jo më pak se 350 mijë të rinj shqiptarë, ndërkohë që aplikimet për punësim në Gjermani, Zvicër e Itali e tejkalojnë shifrën e të gjithë të punësuarve në shtetin shqiptar…

## HOROSKOPI

### DASHI

Dita juaj do të shënohet me emocione të përziera, të cilat mund t'ju mbajnë të tensionuar. Por, nuk duhet të shqetësoheni shumë, pasi mbrëmja do të jetë argëtuese. Përmirësimi i financave është i sigurt.

### DEMI

Tregohuni i kujdesshëm për shëndetin, sidomos nëse keni probleme me tensionin. Marrëdhënia juaj romantike nuk do të jetë në momentet më të mira. Disa kërkesa të partnerit mund t'ju shtojnë nivelin e stresit.

### BINJAKET

Shmangni konfliktet, pasi mund t'ju përkeqësojnë shëndetin. Ju do të jeni shumë të ndjeshëm ndaj vërejtjeve të bëra nga partneri. Nëse i kushtoni më shumë kohë dëshirave tuaja, do të ndiheni i lumtur.

### GAFORJA

Nuk është një ditë shumë e mirë për të udhëtuar. Megjithatë, mbrëmja do të jetë shumë e qetë duke ju bërë të hidhni pas krahëve momentet e tensionit, veçanërisht në punë.

### LUANI

Kaloni më shumë kohë me miq të ngushtë për t'u çlodhur. Mos shpenzoni shumë për t'u bërë përshtypje të tjerëve. I dashuri juaj do të kërkojë më shumë përkushtim dhe përpiquni të shmangni përplasjet me partnerin.

### VIRGJERESHA

Mund të merreni me aktivitet sportiv, i cili do të ruajë aftësinë tuaj fizike dhe mendore. Investimet duhet të bëhen me një perspektivë afatgjatë. Sot dikush nuk do t'ju thotë të gjithë të vërtetën.

### PESHORJA

Vitaliteti juaj i ulët do të veprojë si helm kronik në sistemin shëndetësor. Është më mirë ta mbani veten të angazhuar në ndonjë punë krijuese. Është më mirë të jesh i kujdesshëm për të ardhmen tënde se sa të shqetësoheni për të.

### AKREPI

Kjo është dita e përkryer për të tërhequr vëmendjen e të tjerëve pa shumë lodhje. Planetët do t'ju sjellin shumë arsye për t'u kënaqur sot. Ju mund të keni mjaft kohë sot, por mos i humbni momentet tuaja të çmuara, duke ndërtuar kështjella në ajër.

### SHIGJETARI

Ju do të shijoni kënaqësinë e kohës së lirë. Një marrëveshje e re financiare do të finalizohet, duke ju siguruar më shumë të ardhura. Pasditja me miqtë do të ishte një alternativë pikante.

### BRICJAPI

Përdorni ide inovative për të bërë më shumë para. Mos e neglizhoni jetën tuaj shoqërore. Gjeni kohë nga orari juaj i ngarkuar dhe dilni për të marrë pjesë në një festë familjare.

### UJORI

Shëndeti do të jetë i përsosur sot. Natyra juaj konkurruese do t'ju mundësojë të fitoni ndonjë konkurs. Pas shumë kohësh, mund të jeni në gjendje të plotësoni dëshirën për më shumë qetësi në romancë.

### PESHQIT

Përpiquni të përmirësoni shëndetin dhe personalitetin e përgjithshëm për një jetë më të mirë. Parashikohet të përjetoni ditën më të mirë të jetës suaj në çift. Edhe nga ana shpirtërore do të ndiheni i plotësuar.




### Lojtari kuqezi shënoi gol për Albaseten

# Manaj dëmton rivalin, tifozët e kërcënojnë me jetë

Rei Manaj, protagonist në fushë dhe jashtë saj. Sulmuesi kuqezi i Albasetes shënoi golin e parë në takimin që ekipi i tij e fitoi 3-1 në fushën e Majorkës, por veç kësaj, dëmtoi rëndë një nga rivalët në dyluftim, ndërsa nga tribunat e stadiumit të skuadrës ishullore erdhën koret "vrasës, vrasës" nga tifozëria vendëse dhe që kishin për shënjestër pikërisht lushnjarin e Albasetes. Manaj ka dashur ta sqarojë episodin në fjalë, teksa ka deklaruar për mediat vendëse se ndërhyrja ishte e paqëllimtë. "Ishte një ndeshje e luftuar dhe më vjen mirë që fituam. Ndërhyrja ndaj Siskos ishte e paqëllimshme, pasi të dy vrapuam për të marrë topin dhe ishte një dyluftim sportiv. Kam marrë disa mesazhe kërcënuese, ku më kërcënojnë me jetë si në rrjetet sociale, ashtu edhe në fushë. Vetëm respekt për njerëzit dhe asgjë tjetër. Futbolli është kështu, mund të më kishte ndodhur edhe mua. Vrapuam për të kapur topin dhe fati e deshi që të ndodhte kështu. Duhet të qëndrojmë me këmbë në tokë, pasi këtu janë shumë gjëra. Nëse bëhesh mendjemadh, kundërshtari mund të ndërhyjë ndaj teje dhe të të shkaktojë faull e takimin tjetër të mungosh".

Rei Manaj çeli rezultatin e takimit në minutën e 3-të, ndërsa ky ishte goli i tij i dytë në kampionat për Albaseten. Lojtari u sulmua nga tifozët e Majorkës dhe në profilet e tij zyrtare në rrjetet sociale.

### Kastrioti dhe Laçi barazojnë 1-1. Në Fushë-Krujë ka gola dhe kartonë të kuq për një pikë

# Kukësit i mjafton Shameti, Laçi "ngec" me Kastriotin

## *Verilindorët mposhtën Kamzën 1-0*



Jeton Selimi

Mjafton një gol i kapitenit Ylli Shameti që Kukësi të thyejë Kamzën dhe të sigurojë fitoren e tretë radhazi, fitore që e lejon të mbajë ritmin e Partizanit në vendin e dytë dhe të afrohet me vetëm 1 pikë me Skënderbeun e vendit të parë. Në "Loro Boriçi" nënkampionët shënojnë në minutën e 30-të falë goditjes së saktë të numrit 4, që më pas ka një dedikim special për Bledar Musollin, mesfushorin që do të qëndrojë 6 muaj larg fushave. Gjithsesi, takimi nuk qe aq i thjeshtë, pasi Kamza bëri çmos që të barazonte, por edhe Kukësi kishte mundësitë e veta për të dyfishuar rezultatin. Megjithatë, asgjë nuk do të ndryshojë deri në fund dhe të besuarit e Cungut konfirmohen forcë e dytë në kampionat, ndërsa Kamza do të mbetet në kuotën e 6 pikëve. Kastrioti dhe Laçi ndahen në paqe. Paqe sa i takon rezultatit, se në fushën e lojës nervat i kanë tradhtuar të dyja ekipet. Krutanët kërkonin pikë pas një serie negative prej 3 humbjesh radhazi, ndërsa kurbinasit donin fitoren e dytë në këtë kampionat. Në "Redi Maloku" të Fushë-Krujës, ndeshja në pjesën e parë nuk ka dhuruar raste të mira për shënim (minutat 10 dhe 33), por në kohën shtesë të saj, Emiljano Çela bën një ndërhyrje të rëndë ndaj Fangajt dhe merr kartonin e kuq, për të mos dalë më në pjesën e dytë në fushë. Gjithsesi, forcat do të barazohen, pasi edhe Najdenov (minuta 65) merr të verdhën e dytë, duke e lënë Laçin me 10 veta dhe duke bërë që minutat e fundit të takimit të ishin më emocionuese. Madje, krutanët duket se prekin fitoren, pasi në minutën e 80-të Zhunior godet rreptë nga distanca, duke mposhtur portierin Selmani për avantazhin e Kastriotit. Me minutat që ikin duket se tri pikët po kthehen në realitet për djemtë e Plorit, por Laçi reagon in-extemis dhe Fangaj në të 89'-ën rikthen baraspeshën pas një diagonaleje të saktë. Mbyllet 1-1 në Fushë-Krujë, Kastrioti dhe Laçi marrin nga një pikë, me krutanët që zbresin në vendin e fundit Luftëtarin.



**SUPERLIGA**

**Java e 5-të**

| | |
|---|---|
| **Të premten** | |
| Partizani - Flamurtari | 2-0 |
| **Të shtunën** | |
| Luftëtari - Teuta | 3-1 |
| Skënderbeu - Tirana | 1-1 |
| **Të dielën** | |
| Kastrioti - Laçi | 1-1 |
| Kukësi - Kamza | 1-0 |

**RENDITJA**

| SKUADRA | N | P |
|---|---|---|
| SKËNDERBEU | 5 | 11 |
| KUKËSI | 5 | 10 |
| PARTIZANI | 5 | 10 |
| FLAMURTARI | 5 | 7 |
| LAÇI | 5 | 7 |
| KAMZA | 5 | 6 |
| TIRANA | 5 | 5 |
| TEUTA | 5 | 5 |
| KASTRIOTI | 5 | 4 |
| LUFTËTARI | 5 | 3 |

### Të premten luhet derbi Tirana-Partizani

Java e 6-të e Kategorisë Superiore, ndryshe nga sa jemi mësuar deri tani, do të jetë e ndarë në vetëm dy ditë. Një ditë do t'i përkushtohet derbit të kryeqytetit mes Tiranës dhe Partizanit, ndërsa dita tjetër do të jetë për katër sfidat e tjera të Superiores. FSHF-ja ka vendosur një ngjeshje të tillë për faktin e thjeshtë se java e 7 do të zhvillohet në mesjavë. Kësisoj, java e 6 do të nisë të premten me derbin e kryeqytetit në "Selman Stërmasi", me duelin që luhet në orën 19:45 për të tërhequr sa më shumë shikues. Të nesërmen, pra të shtunën, do të luhen të katër ndeshjet e tjera të ndara në dy orare. Në orën 15:45, skuadra e Kukësit do të presë ekipin e Luftëtarit, në një duel ku do të përpiqet të konfirmojë rezultatet e deritanishme e shpresojë në ndalesën e rivalëve të vet. Paralelisht me të, në Kamëz do të luhet sfida mes ekipit vendës dhe Laçit, një tjetër duel që parashikohet i ndezur. Në darkë, në orën 18:45, në Vlorë do të luhet dueli mes Flamurtarit dhe Kastriotit, ndërsa në Durrës, Teuta do të presë Skënderbeun në një tjetër supersfidë të ndezur.

## SERIE A

# Juventusi dhe Napoli vazhdojnë marshimin

Juventusi iu fal dy golave në minutat e fundit të lojës, për të marrë 3 pikë nga transferta e Frosinones, e cila në nisje dukej thjesht si një formalitet. Ekipi i Alegrit dominoi totalisht ndeshjen, duke goditur plot 7 herë kuadratin e portës, por rezultatin e zhbllokoi Ronaldo vetëm në minutën e 81-të, që shënoi një gol nga brenda zone. Për të siguruar fitoren e pestë radhazi, mendoi edhe Bernardeski, që shënoi golin e dytë në të 94-tën. Bardhezinjtë vinin me disa ndryshime në formacion ndaj Frosinones, teksa disa prej titullarëve ishin lënë pushim, por gjithsesi në fund e shohin veten në krye të tabelës së klasifikimit, me 15 pikë, 3 më shumë se Napoli i vendit të dytë, që nga ana e tij ka arritur të fitojë në transfertë përballë Torinos me rezultatin 1-3. Insinje në minutën e 4-t ka shënuar golin e parë për napolitanët, ndërkohë që në minutën e 20 ka qenë radha e Verdit për të dyfishuar rezultatin. Me fillimin e pjesës së dytë, u duk sikur Torino do të reagonte, pasi shënoi golin e parë në minutën e 51 me anë të Belotit, që ekzekutoi saktë një penallti, por ka qenë sërish Insinje në minutën e 59, ai që ka vulosur fitoren e Napolit. Titullar në këtë takim luajti si gjithmonë edhe Elseid Hysaj.

## LA LIGA

# Girona bën mrekullinë e radhës, ndal Barcelonën

Surpriza Girona në La Liga, vazhdon të qëndrojë e tillë. Mbrëmjen e djeshme ishte Barcelona, që u ndal në këtë derbi me shifrat 2-2. Ndeshja filloi me një gol të Mesit në minutën e 19-të, por vetëm në të 35'-tën, qendërmbrojtësi i blaugranave, Lenglet, goditi me bërryl kundërshtarin dhe u ndëshkua menjëherë me karton të kuq. Pikërisht, Girona përfitoi nga ky superioritet numerik dhe barazoi në fund të pjesës së parë me Stuanin. I njëjti autor



bëri të pamenduarën me fillimin e pjesës së dytë, duke përmbysur rezultatin. Gjithsesi, Barcelona arriti të barazonte në minutën e 63-të, me një gol me kokë të Pikes. Deri në fund, sulmet e ekipit të Valverdes nuk u konkretizuan dhe në fund ndeshja u mbyll 2-2. Me këtë barazim, Barcelona dhe Reali ndajnë vendin e parë me nga 13 pikë, ndërkohë në krahun tjetër, Girona vazhdon nisjen fantastike në këtë sezon, pasi në javën e pestë të kampionatit spanjoll mban vendin e gjashtë në renditje, me 8 pikë.


www.gsh.al
GAZETA SHQIPTARE
Gazeta e gjithë shqiptarëve!
GSH
www.gsh.al
Kontakt: +355 68 40 63 842
Facebook: Gazeta Shqiptare
Intagram: gazetashqiptare.al
Twitter: Gazeta Shqiptare
E-mail: gazetashqiptare.al@gmail.com
YouTube
Youtube: Gazeta Shqiptare
• Na merrni!
• Na shkruani!
• Na lexoni!
GAZETA SHQIPTARE
PENSIONET E PLEQERISË, ISSH: SI T'I LLOGARISNI
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al